

RAPORTI I MONITORIMIT TË GJYKATAVE 2017

Autorë:
Labinot Leposhica dhe Arbër Kadriu

Redaktor:
Faik Ispahiu

Lektorimi:
Përparim Isufi

Koordinator i Projektit të Monitorimit:
Petrît Kryeziu¹

Monitorues:
Arita Gërxhaliu, Blerta Iberdemaj, Shkodran Nikçi, Lekë Muqaj,
Bahrie Sadiku, Naim Krasniqi, Behar Mustafa

Kontribues:
Kastriot Berisha, Agita Muhadri, Genc Kadriu

Publikim i BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA.

Të gjitha të drejtat e rezervuara nga BIRN dhe
INTERNEWS KOSOVA.



¹ Petrît Kryeziu ka ushtruar detyrën e koordinorit të projektit të monitorimit deri në dhjetor të vitit 2017, prej kur edhe është dekretuar si Prokuror i Shtetit.

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive	4
II. Metodologjia	4
III. 'Lufta' e institucioneve kundër korrupsionit	5
1.Retrospektivë e trajtimit dhe analizimit të veprave penale të korrupsionit nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA	5
2.Dënimet për veprat penale të korrupsionit për vitin 2017	6
3.Dështimi i aktakuzave në gjykatë	11
4.Dështimet në luftën kundër korrupsionit	12
A.Aktgjykimet liruese	12
B.Dënimet e ulëta dhe zvarritja e rasteve të korrupsionit	23
C.Pasuria e konfiskuar nga veprat penale të korrupsionit	34
D.Parashkrimi i veprave penale të korrupsionit	36
IV. Gjetjet e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA për shkeljet procedurale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve	37
1.Dështimi i seancave gjyqësore	37
2.Mos caktimi i seancës gjyqësore	39
3.Ndërrimi i deklaratave të dëshmitarëve	40
4.Mos respektimi i afatit ligjor për mbajtjen e shqyrtimit fillestar	41
5.Vonimi i drejtësisë	43
6.Prishja e rendit në shqyrtim gjyqësor	43
7.Mbajtja e gjyqimit pa prezencën e të akuzuarit	44
8.Përgatitja e dobët e prokurorëve për gjykim	45
9.Mos dërgimi i shkresave të lëndës	46
10.Mungesa e interpretëve gjyqësorë	46
V. Shkeljet teknike	46

I. Përmbledhje ekzekutive

Për 12 vjet, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA vazhdojnë monitorimin e sistemit gjyqësor në Kosovë në të gjitha nivelet me qëllim të vlerësimit të performancës dhe respektimin e ligjshmërisë, etikës së punës dhe procedurave gjyqësore nga ana e përgjegjësve të këtij sistemi.

Ky raport² fokus të veçantë do t'i ketë në rastet e terrorizmit dhe ato të korrupsionit, si veprat penale më me interes për shoqërinë të monitoruara gjatë vitit 2017, por gjithashtu do të trajtojë probleme të tjera të vëzhguara gjatë punës së monitoruesve në teren.

Për më shumë, raporti do vëjë në dukje shkelje procedurale nga gjykatësit, prokurorët dhe palë tjera në procedurë gjyqësore, të hasura nga monitoruesit tanë gjatë monitorimit të gjykatave në nivel të Republikës së Kosovës.

Raporti përmban shkelje procedurale, duke nisur nga dështimi i seancave gjyqësore, ndërrimi i deklaratave të dëshmitarëve, mos- caktimi i seancës gjyqësore, vonesat e paarsyetuara të gjyqësorëve, mos- respektimi i afatit ligjor për mbajtjen e shqyrtimit fillestar, mbajtja e gjykimit pa prezencën e të akuzuarit, prishja e rendit në shqyrtim gjyqësor, përgatitja e dobët e prokurorëve për gjykim, e deri te dështimi i mbajtjes së gjyqësorëve për shkak të mungesës së interpretëve gjyqësorë si një ndër parimet bazë në drejtësi për mbajtjen e procesit gjyqësor në gjuhën të cilën e njuh dhe flet i pandehuri në procedurë.

Sikurse në vitet paraprake, edhe këtë vit nuk do të mungojnë të gjeturat nga shkeljet teknike gjatë seancave gjyqësore. Edhe pse me përmirësime dukshëm më pozitive nga viti në vit, raporti i BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, edhe në vitin 2017 sjell statistika krahasimore me vitet paraprake lidhur me shkeljet teknike, siç janë; moslajmërimi i duhur i seancave gjyqësore, fillimi me vonesë i tyre, përdorimi i telefonave gjatë seancës, mospërdorimi i pajisjeve për audio dhe video-incizimin e seancave gjyqësore, pasivitetin e anëtarëve të trupit gjykues dhe shkelje tjera teknike të evidentuara gjatë këtij viti, të cilat do të adresohen në pjesën e fundit të raportit.

Në fund, për të njëmbëdhjetin vit me radhë, raporti i BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA do të ofrojë edhe rekomandime konkrete për institucionet/palët e interesit të përfshira në punën e gjyqësorit në Kosovë.

II. Metodologjia

Gjatë përpilimit të këtij raporti janë përdorur metoda vëzhguese e drejtpërdrejtë, analizuuese, krahasuese dhe statistikore – varësisht nga tema apo kapitulli i trajtuar.

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i punës së gjykatave bazohet në monitorimin e 307 seancave të monitoruara gjatë vitit 2017, me fokus të veçantë në rastet që ndërlihen me terrorizmin dhe korrupsionin.

Metoda Analitike do të vijë në shprehje gjatë analizimit të kapitujve të veçantë të cilët janë paraqitur në raport, duke trajtuar kështu problemet mjaft komplekse të cilat ngërthejnë në vete temat në fjalë.

Përmes metodës së krahasimit do të tërhiqen paralele të caktuara dhe në këtë mënyrë të gjitha problemet që trajtohen do të pasqyrohen shumë qartë. Për të parë më mirë dhe më qartë zbatimin dhe funksionimin e rregullave procedurale e teknike, natyrisht që metoda krahasimore është më e besueshme në këtë drejtim, dhe me të cilën tashmë BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA përmes të dhënave ndër vite ka arritur ta ketë një bazë të dhënash autentike 11 vjeçare.

Në vitin 2017, ekipi monitorues ka mbuluar të gjitha nivelet e gjykatave në Kosovë (shtatë gjykata themelore dhe degët e tyre, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme).

Këto nivele janë monitoruar në Gjykata të shpërndara në komunat: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Ferizaj, Vushtrri, Skënderaj, Drenas, Kaçanik, Viti, Podujevë,

² Ky raport është përpiluar me të dhëna zyrtare të vitit 2017 (31 dhjetor 2017). Një numër i lëndëve dhe të dhënave mund të kenë ndryshuar gjatë vitit 2018, dhe një pjesë e këtyre ndryshimeve janë reflektuar në fusnotat e tekstit të mëposhtëm.

Rahovec, Suharekë, Klinë, Istog, Gjakovë, Deçan, Dragash, Lipjan, Kamenicë, Novobërdë dhe Malishevë.

Përfshirë 307 seancat e monitoruara gjatë vitit 2017, numri i përgjithshëm i seancave të monitoruara në projektin e monitorimit të gjykatave ka arritur në 10,788, duke krijuar kështu një bazë të fuqishme të dhënash që mundëson bërjen e analizave krahasuese dhe matjen e trendeve dhe progresit të arritur.

2008/2009	2009/2010	2010/2011	2011	2012	10,788 seanca
513 seanca	1,248 seanca	2,147 seanca	2,525 seanca	1,441 seanca	
2013	2014	2015	2016	2017	
820 seanca	501 seanca	600 seanca	686 seanca	307 seanca	

Tabela 1. Tabela me numrin e përgjithshëm të seancave gjyqësore të monitoruara

III. 'Lufta' e institucioneve kundër korrupsionit

1. Retrospektivë e trajtimit dhe analizimit të veprave penale të korrupsionit nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA

Lufta kundër korrupsionit, edhe pse e shpallur si prioritet nga institucionet e drejtësisë, në praktikë, ka vite që po del të jetë e vështirë të vërehet. Një konstatim i fillë është përmendur edhe nga Raporti i Progresit i Komisionit Europian, ku vlerësohej që Kosova është në një fazë të hershme dhe ka një nivel të përgaditjes sa i përket luftës kundër korrupsionit.³

Nga monitorimi i seancave në rastet e natyrës korruptive, dy vite më parë, raporti i BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA kishte ardhur në përfundimin se problemi kryesor te gjykimi i këtyre veprave penale qëndron në vërtetimin e motiveve dhe sigurimin e fakteve që kanë shtyrë kryesit të kryejnë këto vepra penale.

Nga monitorimi ishte vërejtur se, nga njëra anë, prokurorët shpesh ngrejnë akuza pa hetime të kryera mirë, duke ardhur në pozitë që gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, në gjykatë, të ndërmerren veprime hetimore, madje edhe të tërhiqen nga akuzat.

Në anën tjetër, te një numër i konsiderueshëm i gjykatësve është vërejtur mungesë e guximit apo profesionalizmit për të shqiptuar dënime meritore ndaj kryesve të veprave penale, ashtu siç parashihet me ligj dhe ashtu siç publiku pref nga ta që t'i luftojnë dhe dënojnë e rastet e tilla.

Raporti i BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, kishte dokumentuar se për shkak të vonesave të prokurorëve për të ngritur aktakuza, në raste të caktuara kishte ardhur deri te kalimi i afateve, gjë që kishte bërë që raste të rënda të dyshuara për korrupsion të mbesin pa u gjykuar fare, siç ishin: rasti i tenderit të KEK-ut me një kompani të sigurimeve vlera e të cilit kalonte shumë mbi 6 milionë euro; tenderi i armëve të Policisë së Kosovës me vlerë mbi 3 milionë euro dhe rasti i Bankës Private të Biznesit në vlerë mbi 450 mijë euro.⁴

Problem tjetër kyç ishin edhe dënimet e ulëta të shqiptuara ndaj kryesve të vërtetuar të veprave penale të korrupsionit, siç ishte rasti i dënimit të dy ish ministrave të kulturës Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri, rasti i zyrtarit nga drejtoria e urbanizmit në Gjakovë dhe rasti i ish-kryetarit të komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, së bashku me pesë zyrtarë të lartë komunalë të kësaj komune.

³ Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2017.17 prill 2018.f.18. https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/01_kosovo_report_2018_0.pdf

⁴ Shih Raportin e Monitorimit të Gjykatave 2017, faqe 10. Qasur në: http://kallxo.com/wp-content/uploads/2016/05/BIRN-court-report-2015_ALB_web.pdf.

Raporti, me shqetësim të madh dhe me raste konkrete, kishte raportuar edhe për dështimin e trajtimit të rasteve të korrupsionit, për raste të cilat vazhdojnë të mbesin të patrajtuara në prokuroritë dhe gjykatat e Kosovës. Aq më tepër, raste të tilla edhe parashkruhen dhe hidhen poshtë pa u ndëshkuar kryesit e veprave penale. Vetëm nga monitorimi dhe hulumtimi i BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA ishin identifikuar të paktën 22 raste të tilla.⁵

Gjatë monitorimit të rasteve të korrupsionit, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA kishin evidentuar raste të dështimeve në luftën kundër korrupsionit që janë paraqitur të ndara në tri kategori; a) Aktakuzat e “Vonuara” të Prokurorisë, b) Parashkrimi i veprave penale të korrupsionit në Gjykatë dhe c) Dënimet e ulëta për rastet e korrupsionit. Për secilën prej pikave të evidentuara, raporti kishte dalë me raste konkrete, duke rekomanduar dhe inkurajuar gjyqtarët që ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit të ashpërsojnë politikat ndëshkimore dhe të shqiptohen dënime më të larta, duke marrë parasysh që veprat penale të korrupsionit në Kosovë janë prezente në masë të madhe.⁶

Mirëpo edhe tani, dy vite pas kësaj analize dhe pas këtyre rekomandimeve të dhëna, lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet e humbur nga ana e institucioneve të drejtësisë.

Edhe gjatë vitit 2017, Raporti i Monitorimit të Gjykatave nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, ka dalë me disa gjetje shqetësuese në luftën kundër korrupsionit.

Edhe gjatë vitit 2017, institucionet e drejtësisë janë treguar jo efikase dhe të pa fuqishme në ndëshkimin meritor të rasteve të mëdha të korrupsionit.

Raporti vë në pah raste konkrete të dështimit të institucioneve në luftën kundër korrupsionit. Edhe në këtë vit janë hasur raste të pasivitetit dhe mosndëshkueshmërisë deri në parashkrim të rasteve të korrupsionit, ndërsa më shqetësuesja është fakti se nuk ka konfiskim të pasurisë nga kryerja e këtyre veprave penale, të dhëna këto të siguruar nga vet gjykatat të cilat në hollësi do të trajtohen në pikat e mëposhtme të këtij raporti.

2.Dënimet për veprat penale të korrupsionit për vitin 2017

Sipas legjislacionit në fuqi, qëllimi i dënimit ndaj kryesit të veprës penale është që të parandalohet kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të shprehë edhe preventivën gjenerale që të parandalohet personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Qëllimi i dënimit nuk ndalet vetëm te kryesi i veprës penale dhe në parandalimin e personave tjerë që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale. Qëllimi i dënimit është edhe të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, si dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.⁷

Duke monitoruar veprat penale të korrupsionit gjatë vitit 2017, Raporti sjell të dhëna statistikore dhe raste konkrete, në bazë të cilave mund të vihet edhe në përfundimin për arritjen apo jo të qëllimit të dënimit të paraparë me kodin penal në fuqi.

Politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit gjatë vitit 2017 sipas hulumtimit dhe analizimit të BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA del të jetë shumë e butë.

Në 254 aktgjykimet e shpallura në shkallë të parë gjatë vitit 2017, rezultoi se gjykatësit kryesisht zbatojnë politikë të butë ndëshkimore ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit, duke u udhëhequr nga dënimet me gjobë dhe kusht, përderisa ka më shumë aktgjykime liruese sesa dënime me burg.

Sipas të dhënave statistikore të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2017, për veprat penale nga kapitulli i korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare, ka pasur rënie të lëndëve të pranuar të kësaj kategorie penale, mirëpo numri i rasteve të bartura nga vitet e kaluara ende mbetet i lartë.

Të dhënat e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës tregojnë se për rastet nga kapitulli i veprave penale të korrupsionit, gjatë 2017 gjykatat themelore kanë pasur në punë

⁵ Po aty.

⁶ Po aty, shih faqe 8 deri në faqe 25.

⁷ Shih Kodi Penal i Republikës së Kosovës, NR.04/L-082, prill 2012, neni 41. Qasur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2834>

559 lëndë me 1,204 persona.

Gjatë kësaj periudhe, gjykatat themelore kanë pranuar 223 lëndë të korrupsionit, ndërsa i kanë zgjidhur 254 lëndë të tilla, duke zgjidhur kështu 31 lëndë më shumë se që kanë pranuar, ndërsa kanë mbetur edhe 305 lëndë të pazgjidhura.

Mënyrat e zgjidhjes së lëndëve nga Gjykatat Themelore, sipas të dhënave statistikore të KGJK-së për vitin 2017, janë si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Lëndë të kryera



Tabela 2. Mënyrat e zgjidhjes së lëndëve nga Gjykatat Themelore (të dhënat e marra nga KGJK)

Prezenca e lartë e dënimeve me gjobë dhe me kusht krahas dënimeve me burg nga njëra anë dhe numri më i madh i aktgjykimeve liruese krahasuar me dënimet me burg në anën tjetër, tregojnë për politikë të dënimeve të ulët dhe dështim të institucioneve të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, duke marrë parasysh faktin që Kodi Penal parasheh dënime të larta për kategorinë e këtyre veprave penale.

Monitoruesit e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, kanë arritur të sigurojnë të dhëna për veprat penale nga kapitulli i veprave të korrupsionit dhe vendimet gjyqësore të marra nga secila prej shtatë gjykatave themelore në vend.


Në tabelën në vazhdim janë paraqitur të dhënat për secilën gjykatë në lidhje me veprat penale të korrupsionit për vitin 2017:

Gjykatat	Lëndë të trashëguara	Lëndët e pranuar	Lëndë të zgjidhura	Burg	Gjobë	Kusht	Aktgjykim lirues	Aktgjykim refuzues	Mënyrë tjetër	Lëndë të pazgjidhura
Prishtinë	198	73	88	14	14	22	9	9	20	183
Prizren	23	27	36	7	7	8	10	1	3	14
Pejë	22	30	37	2	11	12	4	1	5	15
Mitrovicë	19	20	12	1	5	1	1	2	2	27
Gjilan	45	37	38	1	10	4	11	3	8	44
Ferizaj	17	19	27	7	6	5	2	5	2	9
Gjakovë	12	17	16	0	5	4	3	0	4	13
Total	336	223	254	31	58	56	40	21	44	305
%				13.2%	24.2%	21.0%	18.7%	8.2%	13.2%	

Tabela 3. Të dhënat për secilën gjykatë në lidhje me veprat penale të korrupsionit për vitin 2017

Grafika të politikës ndëshkimore për rastet e korrupsionit:

Gjykata Themelore në Prishtinë



Burg

Gjobë

Me kusht

Aktgjykim lirues

Aktgjykim refuzues

Mënyrë tjetër


Lënd të zgjidhura

32%

Lënd të zgjidhura të pazgjidhura

68%

Gjykata Themelore në Prizren



Burg

Gjobë

Me kusht

Aktgjykim lirues

Aktgjykim refuzues

Mënyrë tjetër


Lënd të zgjidhura

72%

Lënd të zgjidhura të pazgjidhura

28%

Gjykata Themelore në Pejë



Burg

Gjobë

Me kusht

Aktgjykim lirues

Aktgjykim refuzues

Mënyrë tjetër


Lënd të zgjidhura

29%

Lënd të zgjidhura të pazgjidhura

71%

Gjykata Themelore në Mitrovicë



Burg

Gjobë

Me kusht

Aktgjykim lirues

Aktgjykim refuzues

Mënyrë tjetër


Lënd të zgjidhura

31%

Lënd të zgjidhura të pazgjidhura

69%

Gjykata Themelore në Gjilan



Burg

Gjobë

Me kusht

Aktgjykim lirues

Aktgjykim refuzues

Mënyrë tjetër


Lënd të zgjidhura

46%

Lënd të zgjidhura të pazgjidhura

54%

Gjykata Themelore në Ferizaj



Burg

Gjobë

Me kusht

Aktgjykim lirues

Aktgjykim refuzues

Mënyrë tjetër


Lënd të zgjidhura

75%

Lënd të zgjidhura të pazgjidhura

25%

Gjykata Themelore në Gjakovë



Burg

Gjobë

Me kusht

Aktgjykim lirues

Aktgjykim refuzues

Mënyrë tjetër

Lënd të zgjidhura

55%

Lënd të zgjidhura të pazgjidhura

45%

3. Dështimi i aktakuzave në gjykatë

Sa i përket rasteve të korrupsionit, prokurorët kanë dështuar t'i mbrojnë dhe faktojnë aktakuzat e tyre me prova argumentuese. Nga të dhënat e siguruar nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA rezulton se në rastet e aktakuzave të korrupsionit gjatë vitit 2017 kemi pasur aktgjykime liruese në 15.7% të rasteve si dhe aktgjykime refuzuese në 8.26% të rasteve të korrupsionit.

Kjo i bie që në total janë 61 raste, apo 23.9% të gjitha lëndëve të kryera të korrupsionit kanë përfunduar me aktgjykime liruese dhe refuzuese, të dhëna këto që dëshmojnë për "profesionalizmin" e prokurorëve të treguar në hetimin e rasteve të korrupsionit.

Statistikat dëshmojnë për numrin e vogël të dënimeve me burgim dhe numrin e madh të aktgjykimeve liruese, sipas të cilave 61 raste me shumë të pandehur janë shpallur të pafajshëm apo kanë mbetur pa u gjykuar, që në përqindje i bie 23.9% të rasteve të aktgjykimeve liruese dhe refuzuese kanë dështuar në gjykatë. Përderisa burg për veprat penale të korrupsionit është shqiptuar vetëm në 12.5% apo konkretisht vetëm në 32 raste të korrupsionit.

Përqindjen më të madhe të dënimeve në rastet e korrupsionit e përbëjnë dënimet me gjobë, të shprehura në përqindje në 22.83%, dhe dënimet me kusht në 22% të rasteve.

Këto shifra të të dhënave pa dyshim se janë shumë shqetësuese dhe shfaqin luftën e dobët të sistemit të drejtësisë ndaj korrupsionit, të cilat mund të shpiejnë edhe në konkluzionin e persekutimit të qytetarëve "të pafajshëm" për qëllime hakmarrëse nga ana e organeve hetuese të vendit.

Për luftën kundër korrupsionit, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Enver Peci, ka deklaruar se rastet e korrupsionit janë duke dështuar për shumë arsye. Ndër to ai ka theksuar ngeçjet që në fazat e hershme të hetimit. Ai ka kërkuar punë më aktive dhe më profesionale nga prokurorët pasi, sipas tij, një aktakuzë cilësore e lehtëson edhe punën e gjyqtarëve. Kryetari i Supremes, ka shtuar se për rastet kur të akuzuarit gjenden fajtorë për vepra të korrupsionit, gjyqtarët duhet të japin dënime meritore.

"Korrupsioni nuk është duke u luftuar në masën e dëshiruar. Ka probleme procedurale, dhe probleme tjera që po e përcjellin këtë proces. Këtë mund ta them edhe nga shqyrtimi i çështjeve që vijnë në Gjykatën Supreme sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike dhe konsideroj që ka shumë për t'u diskutuar në të gjitha aspektet, nga faza e hetimeve, nga faza e ngritjes së akuzave, faza e gjykimit, nga shqyrtimi i dënimeve", ka thënë kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Enver Peci.⁸

Ndërsa kreu i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, barrën kryesore për aktgjykimet liruese nga ana e gjykatave të të akuzuarave për vepra të korrupsionit e ka hedhur te prokurorët. Ai, po ashtu, thotë se është koha që prokurorët të mos vrapojnë vetëm pas numrave për ta plotësuar normën, por të ofrojnë punë cilësore. I pari i Gjykatës së Apelit ka thënë se në rastet kur vërtetohet fajësia e të akuzuarve për vepra penale të korrupsionit, nuk ka logjikë që të shqiptohen dënime alternative, si me kusht, apo me gjobë.

"Barra më e madhe për dështimin e lëndëve të korrupsionit bie mbi prokurorin, është ai që duhet ta argumentojë akuzën. Nëse një akuzë është refuzuar në shkallën e parë, dhe në shkallë të dytë i refuzohet, atëherë dihet përgjegjësia i mbetet prokurorit, pasi nuk ka qenë në gjendje me e argumentu akuzën e parashtruar në gjykatë", kryetari Hasan Shala.⁹

Raporti, pa dashur të ndikojë në pavarësinë, paanshmërinë dhe meritën e vendimmarrjes së gjyqtarëve në rastet e proceseve gjyqësore nga kapitulli i veprave penale të korrupsionit, shpreh shqetësimin se me hetime të filla nga prokurorët dhe me dënime të ulëta nga gjykatësit nuk po arrihet qëllimi i dënimit ndaj kryesve të fillë të veprave penale.

Këto dënime madje ndikojnë edhe në vet besimin e qytetarëve tek institucionet e drejtësisë, besim ky edhe ashtu i mangët sipas shumë raporteve vendore e

⁸ Intervista me z. Enver Peci, datë 08.12.2017. Shih: <http://kallxo.com/enver-peci-korrupsioni-nuk-po-luftohet-sa-duhet/>

⁹ Intervista me z. Hasan Shala, datë 09.12.2017. Shih: <http://kallxo.com/shala-prokuroret-te-mos-vrapojne-pas-numrave-por-pas-citesise/>

ndërkombëtare.¹⁰

Duke monitoruar veprat penale të korrupsionit gjatë vitit 2017 dhe duke u bazuar në vendimet gjyqësore nga të dhënat statistikore, Raporti vjen në përfundimin se kryesit e këtyre veprave penale në të shumtën e rasteve shpallen të pafajshëm për shkak të paaftësisë së prokurorisë në argumentimin e akuzave të tyre në gjykatë. Ndërsa edhe në rastet kur akuzat mbrohen më suksese dhe Gjykata i gjen fajtorë të akuzuarit, dënimet ndaj kryesve të veprave penale janë shumë të ulëta, duke bërë që ata të mos e ndjejnë qëllimin e dënimit të paraparë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

4. Dështimet në luftën kundër korrupsionit

BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA ka monitoruar me fokus të veçantë rastet e korrupsionit, si dhe punën dhe vendimet e gjyqësorit ndaj kryesve të këtyre veprave penale.

Gjatë monitorimit janë hasur raste të shumë dështimeve të prokurorisë në argumentimin e aktakuzave dhe tërheqjen nga raste të tilla, si dhe dështimin e gjykatësve që ta çojnë në vend qëllimin e dënimit të përkufizuar me Kodin Penal të Kosovës.

Në shembujt në vazhdim, janë prezantuar disa nga rastet më të mëdha të veprave penale të korrupsionit, ku kryesit potencialë të veprave të tilla janë shpallur të pafajshëm apo kanë marrë dënime të ulëta nga gjykatat në raport me kufirin e epërm të dënimeve të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës. Raporti në vazhdim sjell rastet më të mëdha të korrupsionit ku përfshihen zyrtarë të nivelit të lartë si ministra, kryetarë komunash, rektorë, drejtorë drejtorish, kryeinspektorë, kryeshef të Inteligjencës, kryetar të organit shqyrtues të prokurimit, mjekë e zyrtarë tjerë të lartë shtetërorë, të trajtuara si raste të dështimit gjatë vitit 2017.

A. Aktgjykimet liruese

Rasti 1 - Kryefari i OShP-së, Hysni Hoxha, I

Nr. i rastit: PAKR 207/2017

I akuzuari: Hysni Hoxha

Vepra: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

Kolegji i Apelit: Driton Muharremi, Hava Haliti dhe Tonka Berisha

Vendimi i Apelit: I akuzuari lirohet nga akuza

Data e vendimit të Apelit: 14 korrik 2017

Vendimi i Themelores: Hysni Hoxha ishte dënuar me 3 vjet burg¹¹.

Dispozitivi i aktakuzës:

Sipas aktakuzës së prokurorisë, Hysni Hoxha si kryetar i OShP-së i tejkaloi kompetencat e tij ligjore ashtu që më 3 tetor 2014 dhe 9 tetor 2014 në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Rregulloren e Punës së OShP-së, me konkluzionin se është “res judicata”, pa i shqyrtuar, i ka refuzuar ankesat e disa operatorëve ekonomikë të datës 2 tetor 2014.

Bëhet fjalë për ankesat e konzorciumeve “Caraglio SRL” dhe NTSh “Electra” të ushtruara kundër vendimit të autoritetit kontraktues KOSTT lidhur me aktivitetin e prokurimit “Instalimi i Grupeve Matëse në Kufirin në mes të KOSTT (KEK) OSSh, edhe pse për këtë ankesë kompetent për vendosje, sipas aktakuzës, ishte paneli shqyrtues i OShP-së në përbërje prej 5 anëtarëve.

Hoxha nga Gjykata e Apelit u shpall i pafajshëm pasi që, sipas aktgjyqimit të Apelit, nuk është vërtetuar dashja direkte e të akuzuarit Hysni Hoxha për të kryer veprën penale si

¹⁰ Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i VII, Janar 2018, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, fq. 15, qasur me datë 13 mars 2018. Qasur në: http://www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7__SHQIP_FINAL_163414.pdf

¹¹ Shpjegim: Hysni Hoxha është shpallur i pafajshëm me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të Gjykatës së Apelit.

element konstituiu i veprës penale dhe se nuk u vërtetua se me veprimin e tij ka përfituar për vete apo tjetrin dobi pasurore.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/hysni-hoxha-lirohet-nga-akuzat/>

Rasti 2 - Kryetari i OShP-Së, Hysni Hoxha, II¹²

Nr. i rastit: PKR-679/14

Të akuzuarit: Hysni Hoxha, Hysni Muhadri dhe Arsim Robelli si dhe Veton Fetahu i cili kishte arritur marrëveshje për pranim të fajësisë në fillim të gjyqimit.

Vepra: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422/1 lidhur me nenin 31 KPRK, për të cilën parashihet dënimi me burg prej 6 muajve deri në 5 vjet; Falsifikim i dokumenteve nga neni 398/1 lidhur me nenin 31 KPRK, për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe burg deri në 3 vjet; Mashtrim nga neni 335/5 lidhur me par 1 KPRK, për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe burg prej 3 deri në 10 vjet burg; si dhe vepra penale deklarim i rremë nën betim nga neni 391/1 KPRK, për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe burg deri në 3 vjet.

Gjyqtarët: Arben Hoti, Shpresa Hasaj-Hyseni dhe Syzana Qerkini

Prokurori: Sylë Hoxha

Vendimi: Të akuzuarit lirohen nga akuza, më 27 nëntor 2017¹³

Dispozitivi i aktkuazës:

Sipas Prokurorisë, të pandehurit Hysni Hoxha dhe Hysni Muhadri, më datën 20 qershor 2013, në Prishtinë, në cilësinë e personave zyrtarë, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar me dashje direkte dhe me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie kompania "ConexGroup", sh.p.k., Prishtinë, në aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i lokaleve afariste në Qytezën Pejton", të iniciuar nga autoriteti kontraktues – Ndërmarrja Publike Banesore në Prishtinë, i kanë tejkaluar kompetencat e tyre, si dhe nuk i kanë përmbushur detyrat zyrtare të tyre.

Ata akuzoheshin se duke i fshehur provat e siguruara nga ATK-ja para dy anëtarëve tjerë të panelit shqyrtues të drejtuar nga Hysni Hoxha, ku në mungesë të këtyre provave anëtarët e panelit bien në lajthim dhe refuzojnë ankesën e operatorit ekonomik ankuës, me ç'rast kompanisë "ConexGroup" i kanë sjellë dobi materiale në shumë prej 1,779,759.54 euro.

Ndërsa, Arsim Robelli, në cilësinë e ofruesit të shërbimeve të kontabilitetit, përmes biznesit "Es – Services" për biznesin "ConexGroup", me qëllim të realizimit të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për biznesin "ConexGroup", në bashkëkryerje dhe me dashje, përpilojnë dhe përdorin dokumentet e falsifikuara dhe afë raportet e kontributeve për punëtorët e biznesit "ConexGroup" për periudhat tremujore TM-4 2010 dhe TM-4 2011, ku të njëjtat i dorëzojnë në aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i lokaleve afariste në Qytezën Pejton", ku si rezultat i përdorimit të këtyre dokumenteve kompania "ConexGroup" është trajtuar si operator i përgjegjshëm dhe është shpallur fitues i kontratës në vlerë prej 1,779,759.54 euro.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/video-lirohet-nga-aktakuza-hysni-hoxha/>

Rasti 3 - Skender Gashi - U.D. i Kryeinspektorit të Punës

I Akuzuari: Skender Gashi (Në Themelore akuzoheshin edhe Agim Millaku, Murat Vokshi si dhe Jovica Filipoviq, por ata ishin liruar në mungesë të provave)

Nr. i Lëndës: PAKR 345/2017 (PKR 1093/13 në Themelore)

Kolegji i Apelit: Fillim Skoro, Driton Muharremi dhe Abdullah Mehmeti

Vepra: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1, për të cilën

¹² Ky rast tani është vendosur edhe nga Gjykata e Apelit, e cila e ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke e liruar përfundimisht nga akuza të akuzuarit e këtij rasti.

¹³ Vërejtje: Gjykata e Apelit ka vërtetuar aktgjykimin lirues, më 23 prill 2018. Shih: <https://kallxo.com/apeli-ia-verteton-pafajesine-hysni-hoxhes-ne-rastin-e-shenjestuar-per-viza/>

parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg

Vendimi i Themelores: 1 vit burg me kusht

Vendimi i Apelit: Gjykata e Apelit liron të akuzuarin në mungesë të provave.

Dispozitivi: Sipas aktakuzës së përpiluar, të akuzuarit duke vendosur në procedurën e shkallës së dytë sipas ankesës së një kompanie kanë aprovuar ankesën e Avni Salihut, pronar i kompanisë "NTP Bujari", njësisë punuese "As Petrol" dhe kanë nxjerrë vendimin e datës 3 shkurt 2009 duke ndryshuar vendimin e shkallës së parë për shqiptim të gjobës ndëshkuese.

Sipas aktakuzës, vendimi i shkallës së parë përcaktonte që kompania të paguante 22,500 mijë euro gjobë, ndërsa të akuzuarit në shkallë të dytë këtë shumë e kanë zbritur në 4,000 mijë euro, pas ankesës së kompanisë.

Gjykata e Apelit ka cilësuar se nuk prova me të cilat vërtetohet fajësia e të akuzuarit.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/lirohet-u-d-kryeinspektorit-te-punes/>

Rasti 4 - Pal Lekaj, Ish Kryetari i Komunës së Gjakovës

Të akuzuarit: Pal Lekaj, Qazim Mehmedi dhe Nikollë Lleshi

Numri i lëndës: PKR.nr.18/17

Vepra Penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 lidhur me par.2, nënparagrafi 2.4, lidhur me nenin 31, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muaj deri në 5 vjet burg.

Prokurori i rastit: Faik Halili nga Prokuroria Speciale

Gjykatësi: Gëzim Pozhegu

Aktvendim: Hedhet AKTAKUZA e Prokurorisë Speciale PPS.nr. 134/2014 e datës 10.02.2017

Dispozitivi i Aktakuzës

Sipas kësaj aktakuzë Lekaj, Mehmeti dhe Lleshi akuzoheshin se gjatë muajit mars të vitit 2012 në bashkëkryerje kanë tejkaluar kompetencat me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie pasurore për vete apo për tjetrin duke i shkaktuar dëme Komunës së Gjakovës dhe banorëve të fshatit Jahoc të kësaj komune.

Akuza më tej sqaron se veprimet e kundërligjshme janë bërë në deklaratën e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve edhe pse nuk ka pasur mjete financiare.

"(...) në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 2 të LPP-se (...) kishin përgatitur dhe nënshkruar "Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve" në vlerë të parashikuara prej 227,076.00 euro, edhe pse nuk ka pasur mjete financiare të mjaftueshme në dispozicion për këtë aktivitet prokurimi në vlerën e paraparë të tij, (...)", thuhet në aktakuzë.

Gjykata Themelore në Gjakovë pas shqyrtimit të dytë e ka hedhur aktakuzën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarve me arsyetimin se vepra penale për të cilën akuzohen Pal Lekaj, Qazim Mehmedi dhe Nikollë Lleshi nuk ka prova që e mbështesin dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit e kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale. Sipas vlerësimit të Gjykatës Themelore të Gjakovës, veprimet e të akuzuarve në rastin e dhënies së tenderit nuk përbëjnë vepër penale sepse nuk ka dashje, nuk ka përfitim e as dëme të shkaktuara.

Gjykata, nga provat e propozuara në aktakuzë, ka vërtetuar se për ndërtimin e rrugës në fshatin Rripaj-Jahoc, është zhvilluar procedura e prokurimit në të cilën kanë aplikuar dhe konkurruar 12 operatorë ekonomikë dhe sipas kushteve të tenderit që fitues duhet të jetë operatori më i lirë ka fituar firma "Asfalti" SH.P.K në Pejë e cila kishte ofertën më të lirë. Si kusht tjetër për ekzistimin e kësaj vepre është që të akuzuarit t'i tejkalojnë autorizimet e tyre, e në rastin konkret, gjykata ka gjetur se secili i akuzuar ka vepruar në kuadër të autorizimeve të tyre.

Si kusht tjetër që duhet të plotësohet për të ekzistuar kjo veprë penale është përfitimi për vete apo tjetrin apo shkaktimi i dëmit e në rastin konkret nga provat e prokurorisë. Prokurori me asnjë provë nuk ka vërtetuar lartësinë e përfitimit që kanë pasur të akuzuarit apo dëm që ka pasur komuna e Gjakovës apo banorët e fshatit Jahoc por në të kundërtën gjykata ka konstatuar se të akuzuarit jo vetëm që nuk kanë përfituar mirë po as nuk kanë shkaktuar kurrfarë dëmi qoftë komunës apo banorëve të fshatit Jahoc të cilët kanë

participuar me 19.000,00 euro për ndërtimin e kësaj rruge.

Vendimi i Apelit

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë Prokurori i Prokurorisë Speciale për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozimin që Gjykata e Apelit aktvendimin e atakuar ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në RIGJYKIM.

Gjykata e Apelit e Kosovës e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara dhe se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka hedhur aktakuzën ndaj të pandehurve.

Raportimi në KALLXO:

<http://kallxo.com/aktakuza-ndaj-pal-lekajt-per-asfalt-pa-para-te-zotuar/>
<http://kallxo.com/pal-lekaj-para-gjyqit-per-keqperdorim-detyre/>
<http://kallxo.com/pal-lekaj-nuk-ndihet-fajtor-ne-rastin-e-asfaltimit-te-rruges/>
<http://kallxo.com/kundershtohet-aktakuza-ne-gjykimin-e-pal-lekajt/>

Rasti 5 - Driton Gashi, Shefi i AKI-së

I Akuzuar: Driton Gashi

Nr. i rastit: P.nr. 336/16

Vepra: Keqperdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

Gjyqtari i vetëm: Arben Hoti

Prokurori: Feti Tunuzliu

Vendimi: Hedhet aktakuza e Prokurorisë për shkak të tërheqjes së prokurorit nga aktakuza

Dispozitivi i Aktakuzës:

Aktakuza e përpiluar nga prokurori Tunuzliu e ngarkonte Driton Gashin se në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së, më 9 shtator 2013 paraprakisht ka marrë vendimin për zbatimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës të 2 gushtit 2013 duke konstatuar që Luan Ismajli të kthehet në pozitën e udhëheqësit të Divizionit për Sigurimin e Aviacionit në Departamentin për Siguri Publike të MPB-së, pasi paraprakisht ishte larguar nga ajo pozitë.

Në aktakuzë thuhet që vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, pra më 9 shtator 2013. Pas këtij vendimi, po të njëjtën ditë, sipas aktakuzës, Gashi e kishte sjellë edhe vendimin që Luan Ismajli të emërohet në këtë pozitë e pastaj më 4 tetor 2013 e kishte ndryshuar këtë akt-emërim me një akt-emërim të veçantë formal duke e transferuar Luan Ismajlin nga kjo pozitë në pozitën e udhëheqësit të Divizionit për Regjistrim Civil të MPB-së prej 7 tetor 2013 për nevoja të institucionit.

Sipas aktakuzës, Gashi kishte dalë jashtë përgjegjësi taksative të parashikuara me dispozitat e Ligjit për Administratën Shtetërore të Kosovës.

Prokuroria pretendonte se ky transfer ishte ndaluar sipas rregullores për transferimin e nëpunësve civilë ngase nuk ka qenë i përshtatshëm për kushtet dhe beneficionet e pozitës së të dëmtuarit por ka qenë pozitë më e disfavorshme se pozita paraprake dhe ka ndikuar negativisht në zhvillimin e karrierës së tij.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/shefi-aki-se-ishte-aktakuze-deri-javen-e-kaluar/>

Rasti 6 - Rasti Limaj - MTPT 1 dhe MTPT 2

Të akuzuarit: Fatmir Limaj, Endrit Shala, Nexhat Krasniqi, Shpëtim Telaku, Florim Zuka

Numri i lëndës: PKR.nr. 8/2013

Trupi gjyqës: Maria Tuma, Jennifer Seal, Isuf Makolli

Prokurori: Charles Harđaëay

E dëmtuara: Ministria e Infrastrukturës (Buxheti i Republikës së Kosovës)

Veprat Penale:

Fatmir Limaj: Krim i organizuar nga Neni 271 par. 3 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës; Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit nga Neni 339 par. 1 dhe 3 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës; Marrja e ryshfeti në kundërshtim me Nenin 343 par. 1 dhe 2 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës, lidhur me nenin 23 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës (në bashkëkryerje), si dhe lidhur me nenin 117.1 a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik; Vepra të tjera penale në formë të mos- deklarimit të parave të pranuar për fushatë në kundërshtim të Rregullores së UNMIK- kut nr. 2004/02 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale nga neni 10.8 dhe nenet 10.5 lidhur me nenet 5.1 dhe 5.6.

Endrit Shala: Krim i organizuar nga Neni 271 par. 3 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës; Ndihe nga neni 25 i Kodit të Vjetër Penal të Kosovës lidhur me veprën penale shpërdorim të pozitës zyrtare ose i autorizimit; Marrja e ryshfeti në kundërshtim me Nenin 343 par. 1 dhe 2 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës, lidhur me nenin 23 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës (në bashkëkryerje), si dhe lidhur me nenin 117.1 a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Nexhat Krasniqi: Krim i organizuar nga Neni 271 par. 3 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës; Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit nga Neni 339 par. 1 dhe 3 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës; Marrja e ryshfeti në kundërshtim me Nenin 343 par. 1 dhe 2 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës, lidhur me nenin 23 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës (në bashkëkryerje), si dhe lidhur me nenin 117.1 a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik;

Shpëtim Telaku: Krim i organizuar nga Neni 271 par. 3 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës; Ndihe nga neni 25 i Kodit të Vjetër Penal të Kosovës lidhur me veprën penale shpërdorim të pozitës zyrtare ose i autorizimit.

Florim Zuka: Dhënia e ryshfeti nga Neni 344 par. 1 të Kodit të Vjetër Penal të Kosovës; Keqpërdorimi i Autorizimeve në Ekonomi nga neni 236 par. 1, nënparagrafi 5 dhe par. 2 i Kodit të Vjetër Penal të Kosovës, lidhur me seksionin 117.1. a dhe d të Ligjit mbi Prokurimin Publik

Dispozitivi i aktakuzës:

Fillimisht, Limaj, Shala e Zuka rëndoheshin me aktakuzën e ngritur në nëntor të vitit 2012, atë të njohur si MTPT 1. EULEX-i gjatë shkurtit të vitit 2014 ngriti aktakuzën e dytë kundër Fatmir Limajt. Limaj dhe tjerët akuzoheshin për vepra të ndryshme penale: krim të organizuar, përveçësish, lidhje të kontratave të dëmshme, keqpërdorim të detyrës zyrtare ose të autoritetit, marrje e mitës dhe vepra të tjera të lidhura me korrupsionin në të ashtuquajturën çështje të Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit.

Prokurori pretendonte se buxheti i Ministrisë së Transportit ishte dëmtuar për së paku 890,000.00 euro, thuhej në njoftimin e atëhershëm të EULEX-it. Si rezultat, trupi gjyqës vendosi të bashkojë në një rastet MTPT 1 dhe MTPT 2. Kjo aktakuzë e konsoliduar u ngrit nga prokuroria në fund të shtatorit të vitit 2015.

Sipas aktakuzës së konsoliduar, pika e parë ngarkonte Limajn, Shalën, Krasniqin dhe Telakun me veprën penale krim i organizuar për periudhën 2008-2010. Bëhet fjalë për kohën sa Limaj ka qenë në pozitën e Ministrit të Transportit dhe Postë- Telekomunikacionit (MTPT). Sipas prokurorisë, Limaj ka pasur fuqinë e vendimmarrjes faktike mbi pjesëtarët e grupit të tij, duke përfshirë Endrit Shalën, Nexhat Krasniqin dhe Shpëtim Telakun. Nexhat Krasniqi, sipas aktakuzës thuhej se ka kontrolluar manipulimet e procedurës së prokurimeve. Pjesë e aktakuzës së prokurorisë ishte edhe Telaku, truproja i Limajt.

Pika e dytë dhe e tretë ndaj Limajt, Shalës, Krasniqit dhe Telakut i ngarkonte të njëjtit me shpërdorim të pozitave të tyre zyrtare dhe marrje ryshfeti përmes kryerjes së bisedimeve, premtimeve dhe dhënies së tenderëve për ndërtimin e rrugëve kompanive të ndërtimit "Tali" dhe "Inter- Europa" në shkëmbim të kërkimit dhe marrjes së ryshfeteve.

Sipas prokurorisë, këta tenderë janë dhënë duke anashkaluar dhe manipuluar rregullat ligjore të prokurimit, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, që e ndalon favorizimin e një kompanie mbi një tjetër.

Pika e katërt e aktuzës lidhej me Florim Zukën dhe ngarkonte të njëjtin për dhënie ryshfeti. Gjatë procesit, sipas prokurorisë, tenderi iu dha kompanisë "Tali" për ofertën në vlerë prej 1,192,844.94 euro.

Ndërkaq, akuzat e katërt e prokurorisë e ngarkonte po ashtu Zukën për keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi në lidhje me ndërtimin e rrugës Ponesh- Zhegovc në Gjilan, me pretendimin se Zuka në cilësinë e pronarit të kompanisë "Tali" ka shkelur seriozisht rregullat e veprimtarisë biznesore duke toleruar marrëveshje për rregullim të çmimit me

“Zuka Commerce Company”.

Akuza e gjashtë dhe e fundit në aktakuzë e ngarkonte Limajn për vepra të tjera penale në formë të mosdeklarimit të parave të pranuar për fushatë. Kjo sipas prokurorisë kishte ndodhur më 18 tetor 2007, kur Limaj ka pranuar një kontribut në kampanjën politike nga Ibrahim Mislimi për fushatën zgjedhore për kryetar të Komunës së Prishtinës në 2007.

Aktgjykimi¹⁴:

Të akuzuarit, Fatmir Limaj, Endrit Shala e Nexhat Krasniqi u liruan nga pika e parë e akuzës për krim të organizuar, të dytën për shpërdorim detyre dhe të tretën për marrje ryshfeti, me arsyetimin se nuk është provuar se të njëjtit kanë pranuar kërkesa për përfitime në favor të dhënies së tenderit.

Si rezultat, trupi gjykues nuk ka arritur që të konkludojë që Limaj ka keqpërdorur pozitën e tij zyrtare në dhënien e këtij tenderi, e as që Shala ka asistuar te Limaj, si dhe përmes raporteve të ekspertëve nuk është vërtetuar se Krasniqi ka qenë në dijeni të rregullimeve të çmimeve. Florim Zukës i ishte parashkruar pika e akuzës për dhënie ryshfeti, ndërsa u lirua nga akuza për keqpërdorim në ekonomi.

Po ashtu, për pikën 6 të aktakuzës për mosdeklarim të parave, Limaj u lirua nga akuza. Pala e dëmtuar u udhëzua që të paraqesë kërkesën pasurore- juridike në kontest civil, derisa shpenzimet procedurale do t'i mbulojë buxheti i Gjykatës.

Raportimet në KALLXO;

<http://kallxo.com/?s=mtpt>

Rasti 7 – Shaban Buza - Rektor i Universitetit “Fehmi Agani”, Gjakovë

I akuzuar: Shaban Buza, Rektori i Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë (UGJFA)

Numri i lëndës: PKR.nr.52/17

Vepra Penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 par.1 të KPRK-Së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

Prokurori i rastit: Ali Uka nga Prokuroria Themelore e Gjakovës

Kryetar i trupit gjykues: Nikollë Komani

Aktvendim: Hedhet AKTAKUZA e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I.nr.164/2016, datë 08.05.2017

Dispozitivi i Akuzës:

Sipas aktakuzës, Inspektorati i Arsimit pas inspektimit të bërë ka konstatuar se në Universitetin e Gjakovës në mënyrë të kundërligjshme janë pranuar mësimdhënësit pa dokumentacion të noterizuar, pa dokumentacion të nostrifikuar të diplomave të lëshuara jashtë Kosovës, si dhe janë pranuar asistentë të cilët e kanë kaluar moshën e paraparë me ligj.

“Në periudhën kohore prej 9 tetorit 2015 e deri më 13 shtator 2016, në cilësinë e rektorit në Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë, me qëllim që vetit t’i sjellë dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, si dhe t’i shkaktojë dëm Universitetit, ka keqpërdorë pozitën e tij zyrtar duke tejkaluar kompetencat e tij zyrtare”, thuhet në aktakuzë.

Po ashtu në aktakuzë thuhet se ‘janë pranuar mësimdhënësit pas konkursit për vitin akademik 2015/2016 dhe nga këto janë 7 ligjërues të angazhuar dhe 20 janë asistentë të angazhuar pa konkurs, në këtë mënyrë ka bërë shkelje të ligjit duke dëmtuar të hyrat e Ministrisë së Arsimit’.

Gjykata Themelore në Gjakovë, pas shqyrtimit të dytë e ka hedhur aktakuzën e Prokurorisë Themelore të Gjakovës dhe ka pushuar procedurën penale ndaj të akuzuarit Shaban Buza në cilësinë e Rektorit të Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë, me arsyetimin se pas vlerësimit dhe analizimit të aktakuzës dhe provat e bashkangjitura akuzës kundërshtimit të mbrojtjes dhe provave të bashkangjitura nga mbrojtja ka konstatuar se me asnjërën nga këto prova nuk vërtetohet dhe argumentohet dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari Shaban Buza e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Sipas vlerësimit të gjykatës të bazuar në këto prova veprimet e të akuzuarit nuk

14 Sqarim: Prokurori i EULEX-it, Charles Hardaway ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

përbëjnë veprë penale, por është raport administrativo-juridik, andaj gjykata bazuar në nenin 253 par.1 të KPP-së e ka hedhur aktakuzën dhe e ka pushuar procedurën penale ndaj Rektorit Shaban Buza.

Me asnjë nga provat nuk është argumentuar se "UGJFA" është dëmtuar e këtë fakt gjykata e ka argumentuar edhe nga vet aktakuza ku nuk është e konstatuar se ka palë të dëmtuar se dhe nuk ka kurrfarë konstatimi për lartësinë e dënimit.

Vendimi i Apelit

Kundër këtij aktvendimi ka parashtruar ankesë prokurori i Prokurorisë Themelore të Gjakovës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal me propozimin që Gjykata e Apelit aktvendimin e atakuar ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në RIVENDOSJE.

Gjykata e Apelit e Kosovës e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e prokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjakovës kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara dhe se Gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka hedhur aktakuzën ndaj të pandehurve.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/rektori-universitetit-te-gjakoves-flet-rreth-aktakuzes-kunder-tij/>

<http://kallxo.com/shtyhet-gjykimi-rektorit-shaban-buza/>

<http://kallxo.com/shaban-buza-jam-pafajshem/>

Rasti 8 – Agim Bahtiri - Kryetar i Komunës së Mitrovicës

Nr i Lëndës: PKR.nr.20/16

Vepra Penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 i KPRK-së, për të cilën parashihej dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg

Të akuzuar: Agim Bahtiri, Haxhimef Ferati, Gazmend Kelmendi

Prokuror i Rastit: Agron Bajrami, nga Prokuroria Speciale

Kryetar i trupi gjykuës: Beqir Halili

Vendimi: Hedhje e aktakuzës

Sipas aktakuzës Policia e Kosovës më datën 18 nëntor 2015 ka dorëzuar në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës kallëzimin penal. Prokurori i PSRK-së më 02 shkurt 2016 ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve dhe më 1 mars 2016 ka ngritur aktakuzë ndaj kryetarit të Mitrovicës dhe dy të tjerëve.

Në aktakuzë thuhet se gjithçka kishte nisur më 8 korrik 2014 kur HESALIGHT kishte paraqitur ofertën e parë me çmimin 688,751.00 Euro dhe në këtë ofertë nuk ishte paraparë ndonjë shpenzim shtesë, përfshirë ndonjë lloj të tatimit edhe pse me ligjet e aplikueshme në Kosovë mund të parashihen. Në ofertën e dytë të datës 29 shtator 2014, kompania i kishte prezantuar Komunës së Mitrovicës një ofertë tjetër me produkte të njëjta por me çmim prej 642,377.00 Euro, duke mos e precizuar çështjen e tatimit. Kësaj oferte i është bashkangjitur një tabelë e ofertës së parë jo me çmimin fillestar por me çmimin prej 878,846.00 Euro ne emër të tatimit duke rritur ofertën për 190,095.00 Euro.

Agim Bahtiri dhe Haxhimef Ferati dyshoeshin se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, ndërsa i akuzuari tjetër Gazmend Kelmendi, dyshohej se ka kryer veprën penale të marrëveshjes për kufizimin e konkurrencës përmes ftesave për tender. Gazmend Kelmendi, drejtor i degës në Kosovë të këtij operatori ekonomik, akuzohej se ka paraqitur pranë autoritetit kontraktues (Komunës së Mitrovicës) ofertë bazuar në një marrëveshje të kundërligjshme qëllimi i së cilës ishte që komuna e Mitrovicës ta pranonte ofertën e tillë duke e kufizuar konkurrencën e lirë.

Vendimi i Apelit:

Gjykata e Apelit ka hedhur poshtë aktakuzën e cila e ngarkonte Agim Bahtirin dhe dy të akuzuarit tjerë për keqpërdorim të detyrës. Sipas gjykatës, provat në bazë të të cilave është ngritur aktakuza nuk e kanë mbështetur dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale me të cilat i ngarkonte prokuroria speciale.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/supremja-verteton-hedhjen-poshte-te-aktakuzes-ndaj-bahtirit/>

<http://kallxo.com/kronologjia-e-afere-qe-coi-ne-aktakuzen-ndaj-agim-bahtirit/>

Rasti 9 - Mjekët e QKUK-së

Të akuzuarit: Kushtrim Gashi dhe Sebahate Gashi, mjekë në QKUK

Numri i lëndës: PKR.nr. 95/2016

Trupi Gjykoës: Valon Kurtaj, Shashivar Hoti, Elmaz Zenuni

Prokurori: Dulina Hamiti

Palë e dëmtuar: QKUK

Veprat penale: Në bashkëkryerje, mjekët akuzoheshin për veprën penale 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar' nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK- së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muaj deri në 5 vjet burg.

Po ashtu, në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje ata akuzoheshin se kanë kryer veprën penale 'Ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike' nga neni 262 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK- së, për të cilën vepër parashihet dënimi me gjobë dhe burg deri në 1 vit.

Dispozitivi i aktakuzës:

Sipas aktakuzës, Kushtrim Gashi dhe Sabahate Gashi nga viti 2001 e deri më 20 maj 2015 në cilësinë e personave zyrtarë, mjekë në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë kanë keqpërdorur detyrën zyrtare me qëllim që vetes t'i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme në atë mënyrë që, duke keqpërdorur detyrën zyrtare kanë marrë barna nga lista esenciale me qëllim që të njëjtat t'ua shesin pacientëve të cilët i kanë trajtuar në ordinancën e tyre.

Pika e dytë e aktakuzës ngarkonte ata se pa autorizim kanë ushtruar veprimtari mjekësore në ordinancë specialistike kirurgjike-proktologjike, duke bërë ndërhyrje kirurgjike te pacientët e ndryshëm, edhe pse të njëjtit janë në marrëdhënie pune në QKUK.

Aktgjykimi¹⁵:

Janë shpallur të pafajshëm me arsyetimin se prokurori i rasti nuk ka mundur të sigurojë prova të mjaftueshme për ta mbështetur fajësinë. Ndërsa, sa i përket dispozitivit të dytë të aktakuzës për ushtrimin e kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore, sipas gjykatësit Valon Kurtaj, rasti në fjalë ka të bëjë me kundërvajtje administrative dhe jo me veprën që mjekët akuzoheshin. Pala e dëmtuar, në këtë rast QKUK, është udhëzuar në kontest civil.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=kushtrim+gashi>

Sqarim: Gjykata e Apelit e ka vërtetuar aktgjykimin lirues të shkallës së parë, kështu duke refuzuar ankesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e cila kishte kërkuar dënimin e të liruave nga akuza, apo kthimin e rasti në rigjykim.

Rasti 10 – Mehmet Krasniqi – Kryetar i Komunës së Obiliqit

Të akuzuarit: Kryetari i Komunës së Obiliqit, Mehmet Krasniqi, së bashku me Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Nazmi Gashi, Bajram Paloji, Ramadan Hashani, Hasie Dushi, Azem Spanca, Basri Kqiku, Emri Sopjani dhe Altin Preniqi

Numri i lëndës: PKR.nr. 271/14

Trupi gjykoës: Afërdita Bytyqi, Arben Hoti, Lindita Jakupi

Prokuror: Agron Bajrami

E dëmtuara: Komuna e Obiliqit

Veprat Penale:

1.Mehmet Krasniqi, Xhavit Krasniqi, Haki Raqi: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422. par. 1, lidhur me nenin 31 të KPK- së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

2.Emri Sopjani, Sami Kadriu: Mashtrim nga neni 335 par. 3 dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së, për të cilën vepër parashihet dënimi me gjobë dhe burg prej 3 deri në 10 vite, dhe Nazmi Gashi: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422. par. 1, lidhur me nenin 31 të KPK- së.

3.Bajram Paloji, Ramadan Hashani, Bajram Paloji: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit

¹⁵Sqarim: Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kështu duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

zyrtar nga neni 422. par. 1, lidhur me nenin 31 të KPK- së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

4. Bujar Alidema, Shpend Kelmendi, Basri Kqiku: Mashtrim nga neni 335 par. 3 dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së dhe par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK- së, për të cilën vepër parashihet dënimi me gjobë dhe burg deri në 5 vjet. Hasie Dushi: Mashtrim në detyrë nga neni 426 par. 3 lidhur me par. 2 të KPRK- së, për të cilën vepër parashihet dënimi me gjobë dhe burg prej 3 deri në 12 vjet burg.

5. Haki Raqi, Nazmi Gashi, Xhavit Krasniqi: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422. par. 1, lidhur me nenin 31 të KPK- së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

6. Hasie Dushi, Azem Spanca, Mehmet Krasniqi, Altin Preniqi: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422. par. 1, lidhur me nenin 31 të KPK- së, për të cilën vepër parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

Aktakuza:

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës kishte ngritur aktakuzë më 8 maj 2015 kundër 14 të pandehurve. Në këtë proces gjyqësor ish-krjetari i Obiliqit Mehmet Krasniqi akuzohej për keqpërdorim të detyrës ose autoritetit zyrtar në periudhën e viteve 2012-2013, kur u realizuan projekte për asfaltimin e disa rrugëve në komunën që e drejtonte, së bashku me Haki Raqin, Xhavit Krasniqin, Nazmi Gashin, Ramadan Hashanin, Bajram Palojin, Azem Spancën dhe Altin Preniqin.

Prokuroria për veprën penale të mashtrimit i akuzonte Emir Sopjanin, Sami Kadriun, Bujar Alidemën dhe Shpend Kelmendin, si dhe përsëri Basri Kqikun, ndërsa për mashtrim në detyrë Hasnije Dushin si dhe Haki Raqin.

Aktgjykimi:

Mehmet Krasniqi, Xhavit Krasniqi, Haki Raqi, Nazmi Gashi, Bajram Paloji, Ramadan Hashani, Hasie Dushi, Azem Spanca dhe Altin Preniqi, u liruan nga të gjitha pikat e aktakuzës.

Ndërkaq, Emri Sopjani, Sami Kadriu, Bujar Alidemaj, Shpend Kelmendi dhe Basri Kqiku u shpallën fajtorë për veprën penale mashtrimi dhe u dënuan me kusht.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=mehmet+krasniq>

Sqarim: Pasi çështja është kthyer në rigjykim, më 11 prill të vitit 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë ka liruar përsëri dy zyrtarët e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Rasti 11 – Zyrtarët e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

Të akuzuarit: Bajram Azemi, Bajram Pajaziti – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Numri i lëndës: Pkr.nr. 300/16

Trupi Gjykses: Shashivar Hoti, Beqir Kalluda, Shadije Gërguri

Prokurori: Feti Tunuzliu

E dëmtuar: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Vepra Penale: Në bashkëkryerje veprën penale 'Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar' nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK- së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

Dispozitivi i aktakuzës:

Sipas aktakuzës, Bajram Azemi, në cilësinë e Kryesuesit të Divizionit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në Departamentin për Familjet e Dëshmorëve Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, si dhe i akuzuari tjetër, Bajram Pajaziti në cilësinë e Drejtorit në po të njëjtin departament, kanë dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës, duke i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm Rexhep Haxhës.

Gjithnjë sipas aktakuzës, Bajram Azemi e ka nxjerrë një vendim me anë të të cilit Rexhep Haxhës i njihet e drejta në pension të familjeve të Dëshmorëve, për djalin e tij të ndjerë Bahri Haxha. Ndërkaq, prokuroria pretendon se kërkuesi i pensionit të familjes Haxha nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për njohjen e të drejtës në pension, pasi që nuk kanë pasur dokument nga Shtabi i Përgjithshëm i TMK-së se djali i tyre, i ndjeri Bahri Haxha, është vvarë si pjesëtar i UÇK-së.

Prokuroria i ngarkon të akuzuarit Pajaziti dhe Azemi se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, me pretendimin se Rexhep Haxhës i kanë sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm në shumë prej 13,900,98 euro.

Aktgjykimi:

Gjykata Themelore në Prishtinë më 23 mars 2017 nxjerri aktgjykim lirues. Më pas, ankesa e prokurorisë u aprovua nga Gjykata e Apelit, me ç' rast çështja është kthyer në rigjykim.

Raportimet nga KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=bajram+pajaziti>

Sqarim: Prokuroria Themelore në Prishtinë nuk ka parashtruar ankesë ndaj aktgjykimit të shkallës së parë në Gjykatën e Apelit, ashtu që aktgjykimi lirues i shkallës së parë ka marrë formë të prerë.

Rasti 12 – Xhevahire Vatoci - Zyrtare e Prokurimit në Policinë e Kosovës

Nr. i lëndës: PKR.nr.687/11

Vepra Penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1, për të cilën vepër parashihet dënimi prej 6 muaj deri në 5 vjet burg.

E akuzuar: Xhevahire Vatoci

Prokurori i rastit: Ibrahim Berisha

Trupi Gjykses: Nora Bllaca Dula, Vesel Ismajli, Valbona Selimi

Aktgjykimi: Lirues

Gjykata Themelore në Prishtinë në mungesë provash e ka liruar nga akuza për keqpërdorim detyre ish-zyrtaren e prokurimit në Policinë e Kosovës Xhevahire Vatocin.

Aktakuza:

Xhevahire Vatocin akuzohej nga ish-Prokuroria e Qarkut në Prishtinë se në cilësinë e zyrtares së Zyrës së Prokurimit në Policinë e Kosovës dhe si kryetare e komisionit për vlerësim, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për ndërmarrjen private "HIB Petrol" SH.P.K. nga Ferizaj ka shpërdorur pozitën zyrtare dhe ka fejkualuar autorizimet zyrtare duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë. Sipas aktakuzës, "HIB Petrol" SH.P.K në bazë të derivateve të shpenzuara gjatë periudhës 06 prill 2009 deri 31 dhjetor 2010 ka përfituar shumën prej 280.370,91 euro, shumë kjo me të cilën ka dëmtuar buxhetin e Policisë së Kosovës.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/lirohet-ish-zyrtarja-e-prokurimit-te-policise/>

Rasti 13 - Drejtoresha e Teatrit Kombëtar

Nr i lëndës: PKR.nr.570/16

Vepra Penale: Keqpërdorim i detyrës zyrtare

Të akuzuar: Elmaze Nura, Beqir Beqiri

Prokurori i rastit: Feti Tunuzliu

Trupi Gjykses: Shashivar Hofi, Beqir Kalludra, Shadije Gërguri

Aktgjykimi¹⁶: Lirues

Gjykata Themelore në Prishtinë i ka shpallur të pafajshëm ish-drejtoreshën e Teatrit Kombëtar Elmaze Nura dhe Beqir Beqirin, organizatorin e udhëtimit të aktorëve të shfaqjes "Lisistrata" në Slloveni.

Aktakuza:

Sipas aktakuzës Nura e Beqiri akuzoheshin për keqpërdorim detyre, ngase sipas prokurorisë ishte shkelur Ligji i Prokurimit Publik gjatë përcaktimit të kompanisë që në vitin 2013 dërgoi aktorët dhe rekuizitat e shfaqjes "Lisistrata" në Slloveni.

Elmaze Nura në pozitën e drejtoreshës së Teatrit Kombëtar akuzohej nga prokuroria se nuk i ka respektuar dispozitat e Ligjit të Prokurimit kur është nënshkruar kontratë me

¹⁶ Sqarim: Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ndaj lirimit të Nurës, kështu duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

kompaninë "Alpina Reisen", lidhur me transportimin e aktorëve të TKK-së për në Slloveni për shumën prej 5,000.00 Eurove.

Po lidhur me këtë udhëtim, Beqir Beqiri akuzohet se pas hetimeve policore dhe kërkesës së dokumentacionit drejtuar në TKK më datën 10 shtator 2015, ka ndërhyrë në dosjen zyrtare duke futur edhe dy oferta të dy kompanive të tjera.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/e-pafajshme-ish-drejtoresha-e-teatrit/>

Rasti 14 - Zyrtarët e Universitetit të Prishtinës

Nr: PAKR.nr.402/2017

Të akuzuar: Esat Belaj, Kemajl Gashi, Arian Janova, Leonard Bytyqi, Kushtrim Morina, Mevlydin Beqiri, Gazmend Maliqi, Arton Hoti, Albion Haxhijaha, Muhamed Maliqi, Shaqir Reqica, Amona Orllati. (12 të akuzuar)

Veprat penale: Marrje rryshfeti nga neni 343 par.1 të KPK-së, Ushtrimi i ndikimit nga neni 345 par.1 të KPK-së, Keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 i PRKS-së, Marrja e rryshfetit nga neni 343 par. 1 i KPK-së.

Aktakuza:

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, këto veprime të akuzuarit i kishin bërë përgjatë viteve 2009 dhe 2012. Aktakuza i ngarkon se veprimet e tyre kishin të bëjnë me marrje dhe dhënie të rryshfetit dhe ushtrim të ndikimit për regjistrime të jashtëligjshme në Universitetin e Prishtinës dhe kalimin e provimeve, kryesisht në Fakultetin e Mjekësisë.

Vendim i Gj. Themelore: PKR.nr.682/2014

Esat Belaj – i fajshëm, dënohet me dënim unik burgu prej 2 vite e 8 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 10000 euro.

Kemajl Gashi – i fajshëm, dënohet me dënim unik prej 7 muaj dhe dënim 1500 euro.

Arian Janova – i fajshëm, dënohet me dënim me burgim prej 8 muaj.

Leonard Bytyqi – i fajshëm, 8 muaj burgim.

Kushtrim Morina – i fajshëm, 7 muaj burgim.

Mevlydin Beqiri – i fajshëm, 8 muaj burgim.

Gazmend Maliqaj – i fajshëm, 8 muaj burgim dhe dënim me gjobë në shumë prej 5,000.00 Euro.

Arton Hoti – i fajshëm, 7 muaj burgim dhe dënim me gjobë 4,000.00 Euro.

Albion Haxhijaha – i fajshëm, 8 muaj burgim.

Muhamed Maliqi – i fajshëm, 8 muaj burgim

Shaqir Reqica – i fajshëm, 3 muaj burgim (mundësi zëvendësimi me gjobë).

Amona Orllati – e fajshme, 3 muaj burgim (mundësi zëvendësimi me gjobë).

Vendimi i Gjykatës së Apelit: Të gjithë të akuzuarit lirohen nga akuza.

Të gjithë të akuzuarit janë liruar nga akuza me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. Disa nga të akuzuarit janë liruar nga akuza për shkak të parashkrimit absolut të veprës penale konform dispozitës së nenit 363 par.1 nënpar.1.3. të KPPRK-së lidhur me nenin 91 par.6 të KPPRK-së. Ndërsa, disa të tjerë për shkak të mosprovimit të fajësisë së të akuzuarve.

Rasti 15 - Ministri për Komunitete dhe Kthim

Numri i lëndës: PKR.nr. 95/2017

Gjykatësi individual: Valon Kurtaj

Të akuzuarit: Dalibor Jevtiq, Mihajlo Prlinçeviq dhe Nenad Stojçetoviq

Veprat penale: Në bashkëryerje kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar nga Neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPPRK- së.

E dëmtuar: Ministria për Komunitete dhe Kthim

Aktakuza:

Sipas aktakuzës, Dalibor Jevtiq në cilësinë e ministrit për Komunitete dhe Kthim, më 11 shkurt të vitit 2014 nxori një vendim me anë të të cilit i dha në shfrytëzim të përhershëm makinën e tipit "Hyundai Accent", pronë e ministrisë, kompanisë private Radio KIM-TV Centar me seli në Çagllavicë. Në aktakuzë sqarohet se Jevtiq vendimin për dhënien e makinës e ka marrë në kundërshtim me udhëzimet administrative për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës.

Nenad Stojçetoviq, akuzohej se duke qenë sekretar i përgjithshëm në Ministrinë për

Komunitete dhe Kthim dhe përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së kësaj ministrie, edhe pse e ka ditur se vendimi i ministrit është i kundërligjshëm, e ka urdhëruar Zyrën Ligjore të Ministrisë të përgatisë kontratën për dhënie në shfrytëzim të makinës zyrtare.

Ndërsa, Prliçeviq akuzohet se si person përgjegjës në Departamentin e Administratës dhe Financave në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim të Republikës së Kosovës ka nënshkruar kontratën mes ministrisë dhe kompanisë private më 11 shkurt 2014.

Vendimi i Gjykatës Themelore¹⁷:

Në shtator të 2017-ës Gjykata Themelore në Prishtinë, e ka hedhur poshtë aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK).

Sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë të lartcekurit nuk i kanë tejkaluar kompetencat e tyre dhe as që është vërtetuar se me veprimet e tyre i është sjellë përfitim apo i është shkaktuar dëm dikujt.

Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e Prokurorisë kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë për hedhjen e aktakuzës ndaj Dalibor Jevtiqit, Nenad Stojçetoviqit dhe Mihajlo Prliçeviqit.

Përmes komunikatës bëhet e ditur se Apeli e ka cilësuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë kundër aktvendimit të Themelores, përmes të cilës është hedhur aktakuza dhe pushuar procedura penale kundër tre të akuzuarve për keqpërdorim detyre dhe të autoritetit zyrtar.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=dalibor+jevtiq>

Rasti 16 - Drejtori i Agjencisë së Kosovës për Akreditim

Nr. i lëndës: PKR.nr.476/15

Vepra Penale: 'Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar' nga neni 422, par.1, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muaj deri në 5 vjet burg, 'Marrje e rryshfeti' nga neni 428, për të cilën parashihet dënimi deri në 5 vjet burg dhe 'Dhënie e rryshfeti' nga neni 429, për të cilët parashihet dënimi me gjobë dhe burg deri në 3 vjet

Të akuzuar: Basri Muja, drejtor i AKA-së, Ferdije Zhushi, Armend Muja, Naim Braha (i është parashkruar lënda)

Prokurori i rastit: Abdurrahim Islami

Trupi Gjykoës: Valbona Selimi, Vesel Ismajli, Isuf Makolli

Gjykimi ende është në vazhdim, mirëpo njërit nga të akuzuarit Naim Braha i cili akuzohet për veprën penale të dhënies së rryshfeti, i është parashkruar lënda.

Në këtë proces gjykoësor, Basri Muja dhe Ferdije Zhushi ngarkohen për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje dhe në vazhdim dhe për marrje të rryshfeti në vazhdim dhe bashkëkryerje, ndërsa Armend Muja akuzohet për marrje të rryshfeti në vazhdim dhe bashkëkryerje.

Në kohën për të cilën akuzohen, Basri Muja ishte drejtor i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, ndërsa Ferdije Zhushi zyrtar e kësaj agjencie.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/kerkohet-precizimi-aktakuzes-per-zyrtaret-e-akreditimit/>

B.Dënimet e ulëta dhe zvarritja e rasteve të korrupsionit

Rasti 1 - Kryetari i Komunës së Dragashit¹⁸

¹⁷ Sqarim: Gjykata Supreme e Kosovës ka aprovuar si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga ana e Prokurorisë së Shtetit, në këtë çështje penale. Po ashtu, Gjykata Supreme ka konstatuar se në aktvendimet për hedhje të aktakuzës të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit ka pas shkelje të dispozitave të procedurës penale, mirëpo duke mos prekur në vendimin e formës së prerë në raport me të pandehurit.

¹⁸ Sqarim: Gjykata e Apelit ka kthyer rastin në rigjykim me arsyetimin se ka shkelje esenciale të

Nr. i lëndës: PKR. 131/16

Të akuzuarit: Salim Jenuzi, kryetar i Komunës së Dragashit, Bean Haxhihasani, drejtor i urbanizmit, Vetim Hasani, inspektor i ndërtimitarisë, dhe Nexhat Selaj

Trupi gjykses: Ajser Skenderi, Teuta Krusha dhe Kimete Kicaj

Prokuror: Genc Nixha

Vepra penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg, si dhe Uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme ,nga neni 332 për të cilën parashihet dënimi deri në 3 vjet burg.

Aktakuza:

Sipas aktakuzës së prokurorisë, të ngritur më 10 gusht 2016, Salim Jenuzi akuzohet se nga viti 2009 deri në vitin 2016 në Dragash me qëllim të fitimit të dobisë pasurore për tjetrin dhe shkaktimin e dëmit komunës ia mundësoi pronarit të furrës "Evropa", Nexhat Selajt, përvetësimin e kësaj patundshmërie.

Në pronën shoqërore Selaj më pas kishte ndërtuar objekt dykatësh pa vendim të asamblesë në Dragash, ndërsa këtë gjë nuk e kishin penguar drejtori i Urbanizmit në këtë komunë Behan Haxhihasani dhe inspektori komunal i ndërtimitarisë Vetim Hasani.

Aktgjykimi i Themelores

Salim Jenuzi, kryetari i Dragashit, është dënuar nga Gjykata Themelore në Prizren me një vit burg me kusht. Jenuzi nëse nuk dëshiron që prapa grilave të kryejë këtë dënim, duhet që të mos shkaktojë vepër tjetër penale në dy vitet e ardhshme.

Gjykata e ka dënuar me 6 muaj burg me kusht edhe Nexhat Selën për uzurpim të pronës së paluajtshme. Edhe Sela për t'iu shmangur vuajtjes së këtij dënimi duhet të mos kryejë vepër tjetër penale për dy vjet.

Ndërsa janë liruar nga akuza për keqpërdorim detyre Bean Haxhihasani e Vetim Hasani.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/denohet-kryetari-dragashit/>

<http://kallxo.com/fjala-perfundimtare-ne-gjykimin-e-kryetarit-te-dragashit/>

<http://kallxo.com/gjykimi-kryetarit-per-furren-ne-pronen-komunale/>

Rasti 2 – Sherif Berisha – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Suharekë

Nr. i lëndës: PKR.129/16

I akuzuari: Sherif Berisha – drejtor i arsimit në Suharekë

Trupi gjykses: Rahim Elezi, Nazim Vllaqo dhe Alija Fazli

Prokurori: Mehdi Sefa

Vepra penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg, si dhe Cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë, për të cilën vepër penale parashihet dënimi me gjobë dhe burg deri në 2 vjet.

Aktakuza:

Sipas aktakuzës, Sherif Berisha akuzohej se gjatë viteve shkollore 2014/2015 dhe 2015/2016, duke shfrytëzuar detyrën zyrtare ka tejkaluar kompetencat e tij me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për personin tjetër, në atë mënyrë që punësoi pa konkurs në shkolla të ndryshme në Suharekë 10 persona, nëntë mësimdhënës dhe një kontabilist.

Drejtori i Arsimit po ashtu akuzohej edhe për kryerje të veprës penale – cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë, sepse ua ka mohuar personave të tjerë të drejtën për punësim në kushte të njëjta.

Aktgjykimi:

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Suharekës, Sherif Berisha, është shpallur fajtor dhe është dënuar me burg efektiv në kohëzgjatje prej 5 muajsh. Mirëpo, Gjykata e Prizrenit e pranoi propozimin e avokatit të të pandehurit, i cili kërkoi që këtë dënim ta zëvendësojë me gjobë dhe vendosi ta dënojë me 4 mijë euro gjobë.

Raportimet në KALLXO:

procedurës penale sa i përket të akuzuarit Salim Jenuzi dhe Nexhat Selajt. Ndërkaq, për dy të akuzuarit tjerë, Bean Haxhihasani dhe Vetim Hasani, shkalla e dytë ka vërtetuar aktgjykimin lirues.

<http://kallxo.com/shpallet-fajtor-drejtori-arsimit-te-suharekes/>
<http://kallxo.com/drejtori-arsimit-akuzohet-se-punesoi-10-veta-pa-konkurs/>

Rasti 3 - Drejtorët e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës

Nr. i Lëndës: PKR.nr. 77/2016

Vepra Penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

Të akuzuar: Halim Gecaj dhe Lulzim Kadriu drejtorë të drejtorisë për gjeodezi, kadastrë dhe pronë në periudha të ndryshme kohore, Hetem Sejdiu, Valentina Jashari dhe Nuradin Hasani, anëtarë të komisionit për hapjen e ofertave, si dhe Feriz Zeqiri

Trupi Gjykoës: Beqir Halili, Sabit Rama, Besnik Feka

Prokuror i rastit: Njazi Rexha

Aktakuza:

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, nga 17 nëntori 2010 e deri më 08 korrik 2013, i pandehuri Halim Gecaj akuzohet se në cilësinë e drejtorit për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë në Komunën e Skenderajt ka fejkualuar kompetencat e tij me qëllim që tjetrit t'i sjellë dobi pasurore. Këtë e kishte bërë në atë mënyrë që në kundërshtim me ligjet u kishte dhënë në shfrytëzim personave pronat e Komunës, pa miratimin e Kuvendit Komunal. I pandehuri në këtë mënyrë kishte dhënë në shfrytëzim plot 37 prona.

Lulzim Kadriu, në cilësinë e drejtorit për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë në Komunën e Skenderajt, akuzohet se nga 31 marsi 2014 deri më 15 shkurt 2015, kishte dhënë me qira katër lokale pa miratimin e Kuvendit Komunal.

Në këtë rast për lidhje të kontratës mbi qiramarrje, ka qenë i akuzuar edhe Feriz Zeqiri, por ndaj tij ka pushuar procedura penale, pasi që i njëjti ka vdekur.

Kjo aktakuzë i ngarkon edhe Hetem Sejdiu, Valentina Jashari dhe Nuradin Hasani, të tre këta anëtarë të komisionit për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për dhënie e tokës në shfrytëzim dhe ndërtim për menaxhimin e tregut të gjelbër në Skenderaj. Sipas aktakuzës, anëtarët e komisionit e kanë kualifikuar për procedurë seleksionimi kompaninë NTSH "Doni Comerc", edhe pse ky i fundit nuk i kishte plotësuar kriteret e kërkuara ligjore.

Aktgjykimi:

Gjykata Themelore e Mitrovicës të akuzuarit Halim Gecaj dhe Lulzim Kadriu i ka shpallur fajtorë për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Ndaj tyre ka shqiptuar dënim me gjobë dhe me nga gjashtë muaj burgim.

Në shpalljen e aktgjykimit, gjykatësi Beqir Halili njoftoi të akuzuarit Halim Gecaj dhe Lulzim Kadriu se dënimin me burgim mund ta zëvendësojnë me gjobë në vlerën e përcaktuar prej 1,800 euro.

Kurse nga akuzat janë liruar Hetem Sejdiu, Valentina Jashari dhe Nuradin Hasani.

Rasti 4 - Zyrtarët e PTK-së

Nr. i lëndës: PKR.nr.462/15

Veprat Penale: 'Marrje e ryshfetit' nga neni 428, për të cilën parashihet dënimi deri në 5 vjet burg dhe 'Dhënie e ryshfetit' nga neni 429, për të cilën parashihet dënimi me gjobë dhe burg deri në 3 vjet.

Të akuzuar: Gazmend Isufi, Agim Zeqiri, Zyhdi Hajzeri, Veton Morina, Nerxhivane Daka, Gëzim Curri dhe Valon Kuçi.

Prokurori i rastit: Ibrahim Berisha

Trupi gjykoës: Shashivar Hoti, Valon Kurtaj, Alltene Murseli

Vendimi i Themelores:

Gazmend Isufi, ish-zyrtari i lartë i PTK-së ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me 1 vit burg me kusht dhe 5 mijë euro gjobë.

Agim Zeqiri ishte dënuar me 1 vit e gjashtë muaj burg me kusht si dhe dënim me gjobë prej 1 mijë euro.

Zyhdi Hajzeri me një vit burg me kusht si dhe me gjobë prej 1,500 euro.

Veton Morina është dënuar me dënimin burg me kusht prej 1 viti si dhe 1,000 euro gjobë.

Kurse Nerxhivane Daka, Gëzim Curri e Valon Kuçi u dënuan me nga gjashtë muaj burg me kusht si dhe me nga 500 euro gjobë.

Vendimi i Apelit:

Gjykata e Apelit, në mungesë të provave, ka liruar nga akuza për “marrje të rryshfeti” ish-drejtorin e Kontrollit të Brendshëm në Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK), Gazmend Isufin.

Së bashku me Isufin, Apeli ka liruar edhe gjashtë të pandehurit tjerë për ‘dhënie të rryshfeti’, Zyhdi Hajzeri, Veton Morina, Nerxhivane Daka, Gëzim Curri, Valon Kuqi dhe Agim Zeqiri.

Në vendimin e Gjykatës së Apelit thuhet se provat të cilat janë administruar në shqyrtim kryesor, nuk kanë vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe shpallur fajtorë nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/ish-zyrtari-ptk-se-denohet-kusht-per-ryshfet/>

Rasti 5 - Rasti “Stenta”

Nr. i lëndës:PKR-369/16

Gjyqtarja: Shadije Gerguri

Prokurori: Florije Shamolli – Salihu

Të akuzuarit: Ferida Agani, Gani Shabani, Ali Hocaoglu, Astrit Bakiqi, Borche Petrovski, Lulzim Borovina, Gani Bajraktari, Nexhmi Zeqiri, Daut Gorani, Elfedin Muhaxheri, Reshat Emra, Bedri Zahiti, Hamza Selmani, Ismajl Avdimetaj, Aferdita Selmanaj, Sali Shala, Nehat Rexhepaj, Agron Besimi, Petrit Ademaj, Bajram Meziu, Agron Leka, Driton Miftari, Masar Gashi, Besim Guda, Miri Strana, Shemsedin Shabollari, Fisnik Hima, Luan Pazhari, Ferid Susuri, Galina Berisha, Bajram Preteni, Arton Beqiri, Driton Sylejmani, Abdullah Tuna, Mahmut Qakmak, Shpend Elezi, Blerim Zuna, Lulzim Kamberi, Sami Gjoka, Faik Shatri, Ejup PLLana, Florim Sadiku, Halim Halili, Agim Krasniqi, Hajdin Qitaku, Edmond Haliti, Besnik Koliqi, Afrim Poniku, Ferihane Sefa, Banush Gashi, Nebi Musliu, Dardan Koqinaj, Xhevdet Shabani, Lazer Prekpalaj, Murat Abazi, Rexhep Manaj, Raif Qavolli, Kelmend Pallaska, Arlind Batalli si dhe personat juridik:International Medicine Hospital, Intermed Sh.P.k Eda.

Vepra Penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga Neni 422 par 1 dhe 2 nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.4, vepra penale Dhënia e rryshfeti nga neni 429 paragrafi 2 dhe 3 lidhur me nenin 31, si dhe marrja e rryshfeti nga neni 428 paragrafi 2 dhe 3.

Koha e ngritjes së aktakuzës: 15 qershor 2016

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka ngritur aktakuzë kundër 64 të pandehurve, në mes tyre edhe ndaj Ferid Aganit, ish-ministër i Shëndetësisë dhe Gani Shabanit, sekretar i kësaj Ministrie.

Në këtë aktakuzë janë përfshirë gjithsej 60 persona fizikë dhe 4 persona juridikë. Prej të akuzuarve janë 44 mjekë dhe një infermier të punësuar në institucionet publike shëndetësore, si dhe 13 persona që kanë punuar ose punojnë në institucionet private shëndetësore. Një numër prej tyre janë udhëheqës ose aksionarë të këtyre institucioneve private shëndetësore.

Ferid Agani dhe Gani Shabani akuzohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Sipas aktakuzës, këta të pandehur kanë kryer veprat penale duke vepruar në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Udhëzimet Administrative të Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe duke lejuar pagesat për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore, për periudhën 2011 -2015.

Aktakuza e ngritur në vitin 2016 ende nuk ka hyrë në shqyrtim gjyqësor!

Edhe pse aktakuza është ngritur në qershorin e vitit 2016, edhe përkundër faktit se rasti është nga kapitulli i veprave penale të korrupsionit, edhe pas një viti e gjysmë ende nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor por vetëm është mbajtur shqyrtimi fillestar dhe ai i dytë ndërsa gjykata ka refuzuar kërkesat për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave.¹⁹

¹⁹ Gati një muaj pasi që Gjykata e Apelit refuzoi ankesat e mbrojtësve të Ferid Aganit dhe Gani Shabanit, në lidhje me hedhjen e aktakuzave, me datën 11 qershor 2018 është mbajtur seanca e parë e shqyrtimit gjyqësor kryesor.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=ferid+agani>

Rasti 6 – Valdrin Lluka - Ministër i Zhvillimit Ekonomik

Numri i lëndës: PKR-629/2016

I akuzuar: Valdrin Lluka, Ministër i Zhvillimit Ekonomik dhe Eliana Naka, sekretare e përgjithsme e MTI-së

Vepra penale: Konflikt i interesit nga neni 424 par.2, për të cilën vepër penale parashihet dënimi prej 1 deri në 5 vjet burg.

Trupi Gjykoës: Hamdi Ibrahim, Naser Foniqi dhe Vehbi Kashtanjeva

Prokurorja: Habibe Salihu

Dy seancat e fundit lidhur me këtë rast të caktuara të mbahen më 18 tetor dhe 12 dhjetor kanë dështuar! Dështimi ndodhi për shkak të mungesës së të akuzuarës Eliana Naka ndërsa ngjarja për të cilën po akuzohen ka ndodhur në vitin 2014 kur selënda vazhdon të mbetet e pazgjidhur.

Përshkrimi i Dispozitivit të akuzës:

Sipas aktakuzës, tani ministri Lluka në cilësinë e zyrtarit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë më 23 maj 2014 ka vepruar në kundërshtim me ligjin, ashtu që ka kërkuar që të fillojnë procedurat për zotimin e mjeteve prej 20 mijë euro për OJQ-në “Jakov Innovation Center”, në të cilën OJQ ka qenë themelues dhe njëkohësisht ka pasur edhe pozitën e kryeshefit të Agjencisë për Promovimin e Investimeve.

Për konflikt të interesit në këtë rast akuzohet edhe Eliana Naka e cila sipas aktakuzës, si sekretare e përgjithshme e MTI-së më 2 qershor 2014 duke vepruar në kundërshtim me ligjin, ka marrë vendim që mjetet financiare në vlerë të përgjithshme prej 20 mijë eurove të ndahen në mbështetje të OJQ-së “Jakov Innovation Center”, në të cilën OJQ ka qenë drejtoreshë e bordit.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=VALDRIN+LLUKA>

Rasti 7 - Zyrtarëte AKP-së

Numri i lëndës: PKR. Nr. 734/15

Të akuzuarit: Naser Osmani, Bahri Shabani, Shkëlzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi, Agim Deshishku

Trupi Gjykoës: Shashivar Hoti, Beqir Kalludra, Shadije Gërguri

Pala e dëmtuar: Agjencia Kosovare e Privatizimit

Prokurori special: Fikrije Fejzullahu

Stadi: Në procedurë

Veprat Penale: Naser Osmani, Bahri Shabani: në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422, lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Shkëlzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Agron Kamberi, Adrian Kelmendi: në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422, lidhur me nenin 31, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Agim Deshishku; Vepra Penale Mashtrimi nga neni 261, par. 2 lidhur me par. 1 të KPK-së, dhe Legalizimi i përmbajtjes së remë, në vazhdimësi, nga neni 403, par. 2, lidhur me par. 1 të KPRK-së. Shmangia nga tatimi nga neni 249, par. 2, të KPK-së.

Aktakuza:

Sipas aktakuzës, Naser Osmani e Bahri Shabani ngarkohen se në bashkëkryerje me persona të tjerë zyrtarë dhe duke shfrytëzuar detyrën zyrtare në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nuk e kanë përmbushur këtë detyrë duke ia mundësuar përfitimin e kundërligjshëm pasuror vetes ose tjetrit, përkatësisht blerësit të ndërmarrjes së re “FAN-Podujevë”, Sh.P.K. të pandehurit Agim Deshishku në vlerën rreth 5,400,000.00 Euro. Blerësi i kësaj fabrike sipas kontratës me AKP-në duhej të bënte investime në të. Osmani e Shabani akuzohen edhe se si anëtarë të Bordit Drejtues të AKP-së, kanë vendosur dhe votuar “për” që investimet e bëra jashtë hapësirave të ndërmarrjes të pranohen si investime brenda

saj, duke liru ndërmarrjen e re "FAN-Podujevë" nga monitorimi i AKP-së dhe kushtet e Marrëveshjes së Zotimeve. Me këto veprime Prokuroria pretendon se Osmani e Shabani kanë kryer keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Edhe Shkëlzen Lluka, Naim Avdiu, Melita Ymeraga, Ardian Kelmendi dhe Agron Kamberi në cilësinë e personave zyrtarë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit akuzohen si Osmani e Shabani në lidhje me përfitimin e paligjshëm për vete ose blerësit e fabrikës. Lluka e Avdiu akuzohen se nuk ndërmorën masa edhe për zbatimin e kontratës mes AKP-së e blerësit të fabrikës "FAN". Melita Ymeraga, Ardian Kelmendi dhe Agron Kamberi ishin përgjegjës për monitorimin e investimeve të blerësit të ndërmarrjes "FAN", ndërsa ata ngarkohen se "nuk kanë kontrolluar dhe monitoruar investimet e raportuara nga investitori, nuk kanë verifikuar deklaratimet për investime, nuk kanë bërë monitorimin fizik të investimeve kapitale, verifikimin e dokumentacionit financiar të investimeve kapitale dhe zotimeve për punësim".

Agim Dëshishku, blerësi i fabrikës "FAN", akuzohet se mashtrroi zyrtarët e AKP-së me paraqitje të rreme ose fshehje të fakteve, duke i shtyrë ata të veprojnë në dëm të pasurisë dhe punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje. Dëshishku akuzohet për mashtrim, legalizim të përmbajtjes së rreme dhe shmangie nga tatimi.

Aktakuza ishte ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë më 23 dhjetor të vitit 2014. Në këtë proces gjyqësor nuk ishte mbajtur asnjë seancë që nga 4 prilli i vitit 2016-ës kur ishte mbajtur seanca fillestare, e deri më 12 korrik të 2017-ës. Edhe pse kjo lëndë është lëndë e nivelit të lartë të korrupsionit dhe është kusht për liberalizim të vizave, nga ngritja e aktakuzës në vitin 2014, pas shumë zvarritjeve lënda ende ndodhet në procedurë.²⁰

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=naser+osmani>

Rasti 8 -Shmangia Nga Tatimi

Numri i lëndës: PKR. Nr. 169/2016

Të akuzuarit: Blerim, Skender dhe Fatmir Sinani, Isa Durguti, Samir Sinanaj, Sabit e Ramadan Sogojeva, Enver Hasani dhe Mentor Emini

Trupi gjyqësor: Elmaz Zenuni, Valon Kurtaj, Alltene Murseli

Prokurori special: Faik Halili

Veprat Penale: Krim i organizuar nga neni 274 lidhur me veprën penale dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin, Neni 314.

E dëmtuar: Buxhefi i Kosovës

Aktakuza:

Sipas aktakuzës, Blerim, Skender dhe Fatmir Sinani, Isa Durguti, Samir Sinanaj, Sabit e Ramadan Sogojeva, Enver Hasani dhe Mentor Emini, duke funksionuar si grup i organizuar në periudhën kohore 2010 - 2014, me qëllim që vetes t'i sjellin pasurim të drejtpërdrejtë financiar, i kanë regjistruar bizneset e tyre, disa prej tyre fiktive. Aktakuza sqaron se për t'iu shmangur pagesës së tatimit të akuzuarit kanë lëshuar fatura fiktive dhe ua kanë mundësuar edhe bizneseve të tjera shmangien nga tatimi.

Në bazë të aktakuzës, disa nga bizneset të cilave u janë lëshuar faturat fiktive nga të akuzuarit në fjalë janë: "Konto-Web" me pronar të akuzuarin Isa Durguti, "O and M" me pronar të akuzuarin Mentor Emini, "Banana" me pronar Enver Hasanin, "Qami" shpk, "Crem-com", "KAF-Group", "Trade-KS" shpk, "Adi", "Blera", "AMT-Group", "Jehona", "Uniqagroup Austria", "Ariani", "Lesa" e shumë kompani të tjera.

Me rastin e transferimit të kryetarit të trupit gjyqësor të këtij rasti, Elmaz Zenuni nga Gjykata Themelore në Prishtinë në Gjykatën Themelore në Ferizaj, nuk është bërë i mundur procedimi i shqyrtimit gjyqësor.

Gjykatësi Zenuni ka arritur me këtë procedurë gjyqësore deri te fjala përfundimtare. Me largimin e tij, rasti i është caktuar gjykatësit Hamdi Ibrahimit.

Tani më, me ndërrimin e trupit gjyqësor, edhe në këtë rast të madh nga veprat penale të korrupsionit ashtu siç e parasheh Kodi i Procedurës Penale, procedura do të nisë nga fillimi.²¹

20 Rasti është në fazën e dhënies së mbrojtjes nga ana e të akuzuarve.

21 Shpjegim: Me ndërrimin e kryetarit të trupit gjyqësor rasti ka filluar nga fillimi me ç'rast është dhënë fjala hyrëse ndërsa për momentin seanca është shtyre për kohë të pacaktuar pasi që i akuzuari Skender Sinanaj, ka pranuar të hyjë në negociim të marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Njëherësh Prokurori

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/?s=blerim+sinani>

Rasti 9 -Lushtaku dhe 23 të Akuzuarit e Tjerë

Numri i lëndës:Pkr. 685/16

Trupi Gjykses: Shasivar Hoti

Prokurori: Romulo Mateus – EULEX

Vepra Penale: Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 për të cilën parashihet dënimi prej 6 muaj deri në 5 vjet burg, si dhe vepra tjera të përshkruara për secilin nga të akuzuarit.

Të akuzuarit:

1. EMRUSH THAQI, ka kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim me nenin 422, par. 1, 2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPRK-së.
2. SHEMSI HAJRIZI, ka kryer veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, në kundërshtim me nenin 422, par. 1, 2.1, dhe 2.2 të KPRK-së.
3. SAMI LUSHTAKU, ka kryer veprën penale të Arratisjes së personit të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 405, par.1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (organizim i grupit kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.
4. SAHIT JASHARI, ka kryer veprën penale të Arratisjes së personit të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 405, par.1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.
5. ISMET HAXHA, ka kryer veprën penale të Arratisjes së personit të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 405, par.1, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (organizim i grupit kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.
6. MËRGIM LUSHTAKU, ka kryer veprën penale Mundësim i arratisjes së personave të privuar nga liria në kundërshtim me nenin 406, par.1 dhe 4 të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.
7. DARDAN GEÇI, ka kryer veprën penale Mundësim i arratisjes së personave të privuar nga liria në kundërshtim me nenin 406, par.1 dhe 4 të KPRK-së, në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.
8. BASHKIM DERVISHOLLI, ka kryer veprën penale Dhënie e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale në kundërshtim me nenin 388, par. 1, 2.5 dhe 3 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Lirim i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 407 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.
9. VALON BEHRAMAJ, ka kryer veprën penale Dhënie e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale në kundërshtim me nenin 388, par. 1, 2.5 dhe 3 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Lirim i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 407 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.
10. ARGJENT BEHRAMAJ, ka kryer veprën penale Dhënie e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale në kundërshtim me nenin 388, par. 1, 2.5 dhe 3 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Lirim i kundërligjshëm i personave të

special, Faik Halili, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka hequr dorë nga vepra penale e krimit të organizuar, duke mbetur në tërësi pranë veprave penale tjera, si shmangia nga tatimi dhe keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi. Këtë shqyrtim gjyqësor po e udhëheq kryetari i trupit gjykses Hamdi Ibrahimimi me anëtarët, gjyqtarët profesionist Naser Foniqi e Vehbi Kashtanjeva. Pjesë e këtij procesi gjyqësor ishte edhe i akuzuari Fatmir Sinani, por ndaj tij është veçuar procedura.

privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 407 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

11. YLBER BLAKAJ, ka kryer veprën penale Lirim i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 407 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

12. GZIM AHMETI, ka kryer veprën penale Lirim i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 407 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

13. XHEVDET ZENA, ka kryer veprën penale Lirim i kundërligjshëm i personave të privuar nga liria, në kundërshtim me nenin 407 të KPRK-së në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

14. MERVETE HASANI (LUSHTAKU), ka kryer veprën penale Mundësim i arratisjes së personave të privuar nga liria në kundërshtim me nenin 406, par.1 të KPRK-së.

15. AGIM UKAJ, ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 422, par.1, 2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPRK-së.

16. ISMAIL DIBRANI, ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 422, par.1, 2.1, dhe 2.2 të KPRK-së.

17. SAMI GJOKA, ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 422, par.1, 2.1, dhe 2.2 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, veprën penale Falsifikim i dokumenteve në kundërshtim me nenin 398, par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Mundësim i arratisjes së personave të privuar nga liria në kundërshtim me nenin 406, par.1 dhe 4 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

18. NEXHIB SHATRI, ka kryer veprën penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në kundërshtim me nenin 422, par.1, 2.1, dhe 2.2 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, veprën penale Falsifikim i dokumenteve në kundërshtim me nenin 398, par.1 dhe 2 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Mundësim i arratisjes së personave të privuar nga liria në kundërshtim me nenin 406, par.1 dhe 4 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

19. RRUSTEM RRUKOLLI, ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (pjesëmarrje në grupin kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

20. REXHEP XHOTA, ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (pjesëmarrje në grupin kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

21. FATMIR MJAKU, ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (pjesëmarrje në grupin kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

22. SKENDER TAHIRI, ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (pjesëmarrje në grupin kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

23. SHEREMET JASHARI, ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (pjesëmarrje në grupin kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

24. BAJRAM DIBRANI, ka kryer veprën penale Pengim i të provuarit apo procedurës zyrtare në kundërshtim me nenin 394 par. 1.7 dhe 5 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprën penale Frikësim gjatë procedurës penale në kundërshtim me nenin 395 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së. Ka kryer veprën penale Krim i organizuar (pjesëmarrje në grupin kriminal) në kundërshtim me nenin 283, par.1 në lidhje me nenin 31 të KPRK-së.

Zvarritja e Rastiit: Përkundër që kanë kaluar më shumë se një vit nga koha kur është ngritur aktakuza, ende nuk është kaluar në shqyrtim gjyqësor. Madje deri në muajin shtator të këtij viti nuk ishte caktuar asnjë seancë lidhur me këtë rast. Prokurori e ka quajtur fyerje

për drejtësinë vonesën në procedimin e këtij rasti ndërsa gjyqtari është arsyetuar me numrin e madh të lëndëve dhe rrethana objektive që nuk ka mundur të caktojë këtë rast më herët. Gjithashtu, dy seancat e para fillestare lidhur me këtë rast kanë dështuar për shkak të mungesës së të akuzuarve ndërsa është dashur lëshimi i urdhërit për sjellje me detyrim për të siguruar prezencën e të gjithë të akuzuarve në gjykim.

Raportimet në KALLXO:

<http://kallxo.com/sot-lushtaku-ne-gjyq-per-arratisjen-nga-qkuk-ja/>

<http://kallxo.com/prokurori-fyerje-per-drejtësinë-zvarritja-e-gjykimit-per-arratisjen-nga-qkuk/>

Rasti 10 – Ramadan Muja – Kryetar i Komunës së Prizrenit

Numri i lëndës në Apel:PAKR. 32/14

Vepra Penale: Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën parashihet dënimi prej 6 muajve deri në 5 vjet burg.

Të akuzuar: Ramadan Muja, Sadik Paçarizi, Avni Ademaj, Kadri Ukimeri, Abdulla Tejeci dhe Minir Krasniqi

Trupi gjykoës: Pjetro Bojarczuk kryetar, Driton Muharremi dhe Abdullah Ahmeti
Kryetari i komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, së bashku me pesë zyrtarë tjerë komunal, akuzoheshin se kishin bërë keqpërdorime me prona komunale dhe të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Muja akuzohej për katër pika të keqpërdorimit të detyrës apo autoritetit zyrtar. Me të njëjtën akuzë, bashkë me kreun komunal të Prizrenit, ngarkoheshin edhe pesë zyrtarë të kësaj komune. Sadik Paçarizi, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor, Avni Ademaj, Kadri Ukimeri, Abdullah Tejeci, dhe Minir Krasniqi- drejtor i Drejtorisë së Administratës.

Avni Ademaj, Kadri Ukimeri, Abdullah Tejeci në periudha të ndryshme kohore për të cilat akuzohen, drejtuan Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit, ose ishin ushtrues detyre të saj. Gjashtë të akuzuarit me qëllim dhe për arsye të sjelljes së dobisë pasurore për të tjerët, nuk kanë zbatuar një vendim të Gjykatës Supreme, kanë dhënë në shfrytëzim tokën që ishte nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit dhe në një rast tjetër kanë dhënë në shfrytëzim pa pagesë tokën e komunës, pa përfillur procedurat ligjore. Kjo ka ndodhur gjatë një periudhe kohore prej vitit 2008 deri në vitin 2012, kur zyrtarët komunalë në këtë periudhë kanë kryer edhe një vepër tjetër penale, duke penguar edhe ekspertët tjerë të gjeodezisë për të dëshmuar nëpër seancat gjyqësore të të dëmtuarve nga këto keqpërdorime me toka, në së paku shtatë raste. Për rastin e pengimit të punës së gjykatës emisioni “Drejtësia në Kosovë” kishte shfaqur një reportazh më 11 shtator 2011.

Vlera e disa prej tokave për të cilat zyrtarët komunalë prizrenas akuzoheshin se kanë keqpërdorë detyrën zyrtare kap shumë prej rreth 200,000 euro.

Procedura ndaj kryetarit Muja dhe të tjerëve lidhur me akuzat me të cilat ngarkoheshin ishte nisur nga Gjykata më 25 mars të vitit 2013, për të përfunduar në shkallë të parë në marsin e vitit 2014.

Në fjalën përfundimtare, të procesit gjyqësor, pas mbajtjes së 28 seancave gjyqësore, Muja së bashku me pesë zyrtarët komunalë kërkuan pafajësinë.

Vendimi i Gjykatës Themelore:

Kryetari i Komunës së Prizrenit Ramadan Muja, së bashku me pesë zyrtarë tjerë komunalë, më 13 mars 2014, u gjetën fajtorë dhe u dënuan nga Gjykata Themelore e Prizrenit.

Muja, për katër pikat e aktakuzës, për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar u dënua me burgim prej dy vjetësh, me kusht që ai të mos kryejë vepra tjera penale gjatë 3 vjetëve. Ai po ashtu mori edhe dënimin plotësues, ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike në kohëzgjatje prej 30 muajsh.

Minir Krasniqi ish-drejtor i Administratës Publike u dënua me 1 vjet e 6 muaj burgim me kusht që për dy vjet të mos bëjë vepër tjetër penale. Edhe Krasniqi iu ndalua ushtrimi i funksioneve publike për 18 muaj.

Kadri Ukimeri, ish-drejtor i Gjeodezisë, dhe Sadik Paçarizi, ish-drejtor i Urbanizimit, u dënuan me 8 muaj burgim me kusht që për 2 vjet të mos bëjnë vepër tjetër penale.

Avni Ademaj ish-drejtor i Gjeodezisë dhe Kadastrit u dënua me 5 muaj burgim me kusht që për 1 vit të mos shkaktojë vepra tjera penale.

Edhe përkundër faktit që për veprën penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar" Kodi Penal i Republikës së Kosovës, parasheh dënimin me burgim prej 6 muajve deri në 5 vjet, gjykata e shkallës së parë në Prizren, e udhëhequr nga gjykatësi ndërkombëtar i EULEX-it, i cili gjeti fajtorë zyrtarët komunalë të Prizrenit, vendosi që të mos u shqiptojë dënime me burgim. Në rastin konkret ai shkoi në minimum duke u shqiptuar dënime me kusht.

Ankesa në Apel:

Avokatët mbrojtës, të pakënaqur me vendimin e shkallës së parë, asaj të Gjykatës Themelore të Prizrenit, lëndën e kishin apeluar në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Sipas avokatëve, ankesa u deponua në muajin maj 2014, mirëpo lëndës së kryetarit të Prizrenit iu deshën katër muaj për të shkuar në Gjykatën e Apelit. Kjo vonesë, sipas arsytimit zyrtar nga zyra ligjore e EULEX-it, ishte bërë për shkak të përkthimit të ankesave nga gjuha shqipe në gjuhën angleze.

Një vonesë e paparë në praktikë, edhe pse Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, nuk parasheh ndonjë afat kohor për dërgimin e lëndës në shkallën e dytë në rastet kur kemi të bëjmë me personat që nuk janë në paraburgim.

Mirëpo, marrë parasysh faktin se vepra penale për të cilën Muja së bashku me pesë zyrtarët komunal ishte dënua nga Gjykata Themelore e Prizrenit, bën pjesë në grupin e veprave penale të korrupsionit, lëndë këto të cilat gjyqësori është zotuar që do t'i trajtojë me prioritet, vonesa prej katër muajve ishte vonesë e tejzgatur.

Pas 15 muajsh shtyerje, i erdhi radha edhe kësaj lënde. Më 9 qershor 2015, në Gjykatën e Apelit u mbajt seanca dëgjimore në të cilën mbrojtësit dhe të akuzuarit i arsyetuan edhe një herë ankesat e tyre dhe e kundërshtuan vendimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit si Gjykatë e shkallës së parë. Avokatët, vendimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit e kanë ankimuar me arsyetimin se ka shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, shkelje të ligjit penale dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Zvarritjet kaq të gjata të rastit Muja nuk të japin përshtypjen që gjyqësori është i interesuar që lëndët e korrupsionit t'i trajtojë me prioritet. Për më tepër rasti Muja, të jep përshtypjen se gjykata e apelit ka vepruar në mënyrë selektive, ngase është një numër i madh rastesh tjera të cilët nga dita e ardhjes në punë janë kryer brenda një, dy e tre muajve, për dallim nga rasti Muja të cilin iu deshën mbi një vit kohë për të vendosur.

Në vazhdim, tabela me rastet e trajtuara në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2015;

Nr. i lëndës	I pandehuri	Vepra penale	Data e ardhjes në Apel	Data e kryerjes	Afati kohor
PAKR. nr.233/2015	Xhavit Hajdari	Neni 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së	09.06.2015	19.10.2015	4 muaj
PAKR. nr.296/2015	Bashkim Krasniqi	Neni 425 i KPK-së. Përvetësim në detyrë	23.07.2015	22.10.2015	3 muaj
PAKR 379/2015	Bajram Shehu	Neni 425 i KPK-së. Përvetësim në detyrë	03.09.2015	15.10.2015	1 muaj
PAKR. nr.428/2015	Ilmi Kqiku	Neni 339 i KPK-së Shpërdorim i detyrës zyrtare	29.09.2015	27.10.2015	1 muaj
PAKR. nr.241/2015	Minush Hoxha etj.	Përvetësim gjatë detyrës zyrtare Shpërdorim i detyrës zyrtare...	09.06.2015	02.11.2015	5 muaj
PAKR. nr.173/2015	Bekim Shaqiri	Ushtrim i ndikimit Neni 431 i KPK-së.	01.04.2015	22.10.2015	6 muaj

Tabela 4. Kohëzgjatja e trajtimit të lëndëve në Gjykatën e Apelit në vitin 2015.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit si Gjykatë e shkallës së dytë, shfrytëzoi të drejtën që aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ta kthejë në rigjykim.

Më 31 gusht 2015, pas gati një viti e gjysmë pas shpalljes së aktgjykimit ndaj kryetarit të Komunës së Prizrenit, aktvendimi i Gjykatës së Apelit për kryetarin Muja, zyrtarisht u kthye në Gjykatën Themelore të Prizrenit.

Supremja

Në ndërkohë papritur, zvarritjet e rasti Muja vazhduan edhe më tutje, duke bërë që ai ta vazhdojë drejt përfundimit mandatin e marrë për drejtimin e Komunës së Prizrenit.

Prokurorja e rasti, e pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Apelit, ka vendosur që të parashtojë ankesën në Gjykatën Supreme. Në këtë ankesë, Prokurorja kërkoi nga Supremja, që Gjykata e Apelit ta rishqyrtojë lëndën e Mujës, por me një panel tjetër gjykatësish.

Në ankesën e prokurores së EULEX-it Judit Eva Tatrai thuhet se Gjykata e Apelit ka dështuar për ta adresuar çështjen nëse Gjykata Themelore ka tejkaluar akuzën, siç kanë pretenduar disa avokatë mbrojtës.

“Ne mund të konstatojmë se vendimi i Gjykatës së Apelit vuan nga të njëjtat mangësi të përcaktuara nga ana e tyre në lidhje me aktgjykimin e Gjykatës Themelore”, thuhet në ankesën e Prokurores Tatrai.

“Duke u bazuar në disa arsye, Prokurori i Shtetit kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta anulohet vendimi i Gjykatës së Apelit të datës 22 korrik 2015, dhe t’ia kthejë me një udhëzim që të caktohet rasti në Gjykatën e Apelit nga një kolegji tjetër”, thuhet në ankesë.

Gjykata Supreme, në muajin dhjetor 2015 mori Aktvendim që ankesa e paraqitur nga Prokurori, e datës 04 shtator 2015, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të lëshuar më 22 korrik 2015, për rastin Muja dhe të tjerët, të PRANOHET.

Gjykata Supreme vendosi që aktvendimi i apeluar të anulohet dhe lënda t’i kthehet Gjykatës së Apelit për rishqyrtim nga një trup i ri gjykues.

Në arsyetimin e Gjykatës Supreme ndër të tjera thuhet se ekziston një mospërputhje e dukshme në mes të vlerësimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme sa i përket mundësisë për të proceduar me shqyrtimin e meritave të lëndës nga Apeli. Duke u nisur nga ky fakt, Gjykata Supreme ka vendosur që lënda të kthehet në Gjykatën e Apelit për rishqyrtim nga një kolegji i ri.

“Secili vendim i Gjykatës së Apelit duhet patjetër të jetë i bazuar në vlerësimin e plotë dhe të hollësishëm të faktorëve relevant dhe të jetë i arsyetuar në mënyrë të duhur. Fatkeqësisht, kjo nuk është bërë nga Gjykata e Apelit në aktvendimin e kundërshtuar, andaj është vendosur që lënda t’i kthehet Gjykatës së Apelit për rishqyrtim nga një trup i ri gjykues”, thuhet në arsyetimin e Gjykatës Supreme.

Rasti Muja sërish në rigjykim²²

Pas një heshtjeje të gjatë të Apelit, në fund lënda u kthye në rigjykim, kësaj radhe për t’u gjykuar nga vendorët. Meqë Gjykata Themelore e Prizrenit ishte tërhequr, rasti i shkoi Gjykatës Themelore në Gjiilan. Kjo e fundit caktoi seancën e shqyrtimit fillestar ndaj Mujës dhe të akuzuarve tjerë për datën 14 dhjetor 2017. Datë kjo e cila për “çudi” korespondoi me ditën e parë të tij si qytetar i lirë pa obligime zyrtare pas kryerjes së mandatit të kryetarit të komunës.

Ramadan Muja që më 13 dhjetor 2017 dorëzoi detyrën, më 14 dhjetor 2017 tregoi në gjykatë se është pensionist.

“Dje kam dorëzuar postin e kryetarit të Prizrenit e tash jam pensionist”, tha Ramadan Muja në seancën e gjykimin ku akuzohet për shpërdorim detyre.

Në këtë seancë u paraqitën edhe katër të akuzuarit tjerë, pos Kadri Ukimerit që tashmë është i ndjerë.

²² Rasti i kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore në Gjiilan po udhëhiqet nga kryetari i trupit gjykues Agim Ademi ndërsa akuzat po përfaqësohet nga prokurorja speciale Fikrije Fejzullahu, rasti është në fazën e shqyrtimit kryesor.

Marrë parasysh faktin që ndaj kryetarit Muja dhe pesë zyrtarëve tjerë komunal të Prizrenit, seancat gjyqësore filluan në fillimin e vitit 2013, kanë kaluar pesë vite dhe ende nuk shihet fundi i kësaj lënde, përderisa Muja realizoi qëllimin që të përfundojë mandatit e tij si kryetar i Komunës së Prizrenit.

Ky rast më së miri shpërfaq zvarritjet, brishtësinë dhe dështimin e organeve të drejtësisë për një gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme. Mbi të gjitha ndikon drejtpërdrejt në mosbesimin e qytetarëve në institucionet e drejtësisë dhe në luftën e tyre ndaj veprave penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare.

Raportet në KALLXO;

<http://kallxo.com/?s=RAMADAN+MUJA>

Raporti vë në dukje se rastet e paraqitura më lart janë vetëm disa nga shembujt më eklatantë, në të cilat të përfshirë kanë qenë zyrtarë të lartë shtetërorë dhe kanë përfunduar me tërheqje të prokurore nga aktakuzat dhe shpalljen e tyre të pafajshëm. Përderisa siç pamë, edhe në rastet kur Gjykatat kanë vërtetuar kryerjen e veprave penale të korrupsionit dhe përkundër faktit që ligji u ka dhënë mundësinë për shqiptimin e dënimeve më të larta, siç është dënimi me burgim efektiv, ato kanë zgjedhur të shqiptojnë dënime me kusht.

Raporti konsideron se shqiptimi i dënimeve me kusht dhe gjoha të ulëta ndaj kryesve të gjetur fajtorë për kryerje të veprave penale nga kapitulli “më i ndjekur” nga ana e institucioneve shtetërore nuk tregojnë seriozitetin e pushtetit gjyqësor për luftë ndaj korrupsionit.

BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, inkurajojnë gjyqtarët që ndaj kryesve të veprave penale të korrupsionit të ashpërsojnë politikat ndëshkimore dhe të shqiptohen dënime më të larta, duke marrë parasysh që veprat penale të korrupsionit në Kosovë janë prezente në masë të madhe.

C. Pasuria e konfiskuar nga veprat penale të korrupsionit

BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, gjatë vitit 2017 me theks të vecantë ka monitoruar edhe zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me konfiskimin e pasurisë të fituar përmes veprës penale të korrupsionit.

Lidhur me konfiskimin e pasurisë të përfituar me vepër penale, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton mënyrën dhe formën e konfiskimit, sipas të cilit në aktakuzë duhet të përcaktohet me saktësi çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme, fonde apo pasuri tjera që mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII i këtij Kodi.²³

Sendet e konfiskuara përkohësisht, në fund të procedurës sipas nenit 115 të KPPRK-së, konfiskohen përhershëm. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues urdhëron sekuestrimin e përhershëm të sendeve në pajtim me ligjin, nëse prokurori i shtetit: përcakton në aktakuzë ato sende, pasuri, prova apo para të cilat i nënshtrohen sekuestrimit të përhershëm; nëse gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, provat apo paratë e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale; dhe ligji lejon konfiskimin e tyre.

Sipas nenit 69 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, gjykatës i mundësohet marrja e sendit. Sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale, sipas kodit penal, do të konfiskohen.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, sendet, pasuria apo provat për të cilat është bërë sekuestrimi i përhershëm shiten dhe të ardhurat nga këto shitje përdoren për kompensimin e të dëmtuarve dhe pjesa e mbetur derdhet në buxhetin e

²³ Shih neni 241 par.1 pika 1.9 <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Ligjet/Kodi%20i%20procedures%20penale.pdf>

shtetit.²⁴

Raporti, ka siguruar të dhëna nga secila prej gjykatave në tërë territorin e Republikës së Kosovës lidhur me aplikimin e konfiskimit të pasurisë të përfituar me vepër penale.

Tabela në vazhdim, paraqet rastet e konfiskimit të pasurisë për vitin 2017 nga kryerja e veprave penale të korrupsionit.

GJYKATAT	KONFISKIMI I PASURISË
Prishtinë	1
Prizren	0
Pejë	0
Mitrovicë	0
Gjilan	0
Ferizaj	0
Gjakovë	0

Tabela 5. Rastet e konfiskimit të pasurisë për vitin 2017

Siç mund të shihet nga të dhënat e prezantuara në tabelë, gjatë tërë vitit 2017 në tërë territorin e Republikës së Kosovës ka pasur vetëm një rast në të cilin është konfiskuar pasuria për shkak të përfitimit të asaj pasurie me anë të kryerjes së veprës penale të korrupsionit.

Rasti ka të bëjë me dënimin dhe konfiskimin e pasurisë së ish- gjykatësit të akuzuar Kolë Puka. Më 14 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit e Kosovës ka vendosur sipas ankesave në rastin e të akuzuarit Kolë Puka dhe ka nxjerrë vendimin me anë të të cilit ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 28.06.2017.

Gjykatësi Puka, akuzohej për veprat penale: “Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore”, nga neni 432 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, “Keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar,” nga neni 422 i këtij kodi, si dhe veprën penale “Parandalimi i pastrimit të parave dhe luftimi i pastrimit të terrorizmit”. I akuzuari është dënuar më 3 vjet e 6 muaj burgim dhe 3,000.00Euro gjobë. Atij i është ndaluar ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbime publike si dhe ushtrimi i profesionit të avokatit në kohëzgjatje prej 3 vjetëve pas mbajtjes së dënimit me burgim.

Nga i akuzuari janë konfiskuar paluajtshmëritë e përfituara nga kryerja e veprës penale me vlerë mbi një milion euro (1,000,000.00 Euro) dhe atë; një banesë në Klinë, një banesë në Prishtinë, patundshmëria (në të cilën është e ndërtuar një shtëpi) në Ulqin të Malit të Zi në sipërfaqe prej 308 m2, patundshmëria (livadh) po në Ulqin në sipërfaqe prej 171 m2, një lokal afarist në Klinë, një automjet “Audi A6”, si dhe mjetet financiare nga shitja e dy lokaleve afariste.

Rasti ish-gjykatësit Puka është rasti i vetëm në të cilin është konfiskuar pasuria, përderisa gjatë vitit siç u prezantua në shembujt më lartë ka pasur numër të madh të akuzuarve për keqpërdorime milionëshe.

Nga monitorimi dhe mbledhja e të dhënave statistikore për secilën nga shtatë gjykatat themelore në vend, raporti ka ardhur në përfundimin që nga njëra anë kërkesat e prokurorëve për konfiskim të pasurisë të përfituar me vepër penale kanë qenë të rralla, ndërsa nga ana tjetër rastet e konfiskuara të pasurisë nga ana e gjykatës janë edhe më të rralla (vetëm 1 rast në vitin 2017). Edhe përkundër faktit që jemi dëshmitarë të shumë rasteve të të akuzuarve për keqpërdorime të detyrës nga zyrtarët shtetërorë, me pretendimet për keqpërdorime që kalojnë vlera milionëshe, nuk kemi parë në praktikë të zbatohen dispozitat për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë të përfituar në mënyrë të

24 Neni 115 i KPPRK-së. <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Kodi%20i%20procedures%20penale.pdf>

kundërligjshme.

BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA vlerëson se është koha e fundit kur Prokuroria e Shtetit duhet të reflektojë në prioritetimin e të gjitha rasteve të krimeve të rënda e në veçanti ato të korrupsionit, në mënyrë që mos të vijë deri te mosndëshkimi i keqbërësve, të cilët me kryerjen e veprave të tilla dëmtojnë edhe buxhetin e shtetit. Për më tepër, mos ndëshkimi i këtyre personave ndikon edhe në moskthimin e pasurisë të fituar në mënyrë të paligjshme.

Andaj, Raporti u rekomandon prokurorëve dhe gjykatësve; të parët të zbatojnë dispozitat ligjore për të parashtruar kërkesa, ndërsa të dytët të aplikojnë konfiskimin e pasurisë të përfituar me vepër penale, sidomos në rastet e veprave penale nga kapitulli XXXIV i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

D.Parashkrimi i veprave penale të korrupsionit

Pos dështimit të numrit të madh të rasteve në gjykata, tërheqjes së prokurorëve nga aktakuzat dhe mos argumentimit të tyre para trupit gjykues, dënimeve të ulëta dhe moskonfiskimit të pasurisë për veprat penale kundër korrupsionit zyrtar dhe detyrës zyrtare, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, kanë gjetur raste kur këto vepra kanë arritur parashkrimin/ vjetërsimin absolut në gjykata.

Sa i përket parashkrimit të veprave penale të korrupsionit, Raporti ka siguruar të dhëna nga shtatë Gjykatat Themelore në nivel vendi për periudhën janar – dhjetor 2017, e po ashtu të dhëna për numrin e veprave penale të parashkruara janë siguruar edhe nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Tabela me numrin e të dhënave nga shtatë gjykatat themelore për rastete parashkruara të korrupsionit

GJYKATAT	RASTE TË PARASHKRUARA
Prishtinë	5
Prizren	0
Pejë	0
Mitrovicë	0
Gjilan	0
Ferizaj	0
Gjakovë	0
GJITHSEJ:	5

Tabela 6. Rastet e parashkruara të korrupsionit

Nga tabela me numrin e të dhënave nga shtatë gjykatat themelore në nivel vendi, për rastet e parashkruara të korrupsionit, të dhënat flasin për 5 lëndë tëparashkruara nga kapitulli i veprave penale kundër korrupsionit. Të gjitha rastet janë të paraqitura në Gjykatën Themelore të Prishtinës, përderisa gjashtë gjykatat tjera kanë ofruar të dhëna të cilat tregojnë se nuk ka asnjë rast të parashkruar nga këto gjykata.

Raporti ka shkuar edhe më tutje duke marrë përsipër identifikimin e këtyre rasteve edhe nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Të dhënat e SKGJK-së flasin për një numër më të madh të rasteve të parashkruara nga kapitulli XXXIV që ka të bëjë me "Korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare". Sipas SKGJK-së, për nëntë mujorin e parë të vitit 2017 nga ky kapitull janë parashkruar gjithsej 8 lëndë.

Raporti e sheh alarmant moskorespondimin e të dhënave ndërmjet të dhënave nga Gjykatat dhe ato të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.Për më tepër, mospërputhje të të dhënave të lëndëve të parashkruara të korrupsionit ka pasur edhe në

vitin 2015.²⁵

Përderisa në vitin 2017 të dhënat flasin për numrin më të madh të rasteve të parashkuara të prezantuara nga SKGJK në krahasim me ato të gjykatave, në vitin 2015 SKGJK kishte ofruar të dhëna sipas të cilave nuk kishte pasur asnjë rast të parashkuar të veprave penale përderisa nga të dhënat e gjykatave monitoruesit e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA kishin identifikuar 22 raste të tilla.

Raporti e konstaton alarmit faktin që veprat penale kundër korrupsionit të arrijnë parashkrimin duke lejuar që kryesit potencialë të veprave penale nga kapitulli "më i ndjekur" të mbesin pa u ndëshkuar.

8 rastet e dështuara për të cilët nuk ekzistojnë të dhënat për numrin e personave të përfshirë në këto raste, shpërfaqin dështimin e institucioneve të drejtësisë për të arritur ndjekjen, ndëshkimin dhe për të plotësuar qëllimin e dënimit të paraparë sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Për më tepër lejimi i parashkrimit të rasteve të kësaj natyre, me apo pa dëshirë, bie në kundërshtim me parimin për gjykim të drejtë, të paanshëm dhe në afat të arsyeshëm të paraparë si një ndër parimet bazë në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Raportimi për parashkrimin e veprave penale të korrupsionit edhe në vitin 2017 është kulmi i dështimit të organeve të drejtësisë. Andaj, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, edhe një herë konsiderojnë se institucionet mbikëqyrëse të sistemit prokurorial dhe gjyqësor duhet të reagojnë me vendosmëri dhe pakompromis ndaj parashkrimit të lëndëve të korrupsionit, duke thirrur në përgjegjësi publike dhe penale gjykatësit dhe prokurorët që lejojnë parashkrimin e lëndëve, sidomos ato të korrupsionit.^{26,27}

IV. Gjetjet e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA për shkeljet procedurale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve

Gjatë vitit 2017 janë monitoruar gjithsej 307 seanca gjyqësore duke përfshirë çështjet penale dhe ato civile, nga të cilat janë gjetur shumë shkelje procedurale të bëra nga prokurorët, avokatët dhe nga vet gjyqtarët dhe trupi gjyqësor.

Gjetjet e monitoruesve si shkelje procedurale gjatë vitit 2017 në tërë territorin e Republikës së Kosovës janë të ndryshme. Duke u nisur nga dështimi i seancave gjyqësore, ndërrimi i deklaratave të dëshmitarëve, mosçaktimi i seancës gjyqësore, vonesat e paarsyetuara të gjykimeve, mos-respektimi i afatit ligjor për mbajtjen e shqyrtimit fillestar, mbajtja e gjykimit pa prezencën e të akuzuarit, prishja e rendit në shqyrtim gjyqësor, përgatitja e dobët e prokurorëve për gjykim, e deri te dështimi i mbajtjes së gjykimeve për shkak të mungesës së interpretëve gjyqësorë si një ndër parimet bazë në drejtësi për mbajtjen e procesit gjyqësor në gjuhën të cilën e njeh dhe flet i pandehuri në procedurë.

Në vazhdim, janë të prezantuara në detaje shembuj konkretë sa i përket shkeljeve të gjetura në rastet e monitoruara gjatë mbajtjes së seancave gjyqësore si për rastet penale ashtu edhe për ato civile.

1. Dështimi i seancave gjyqësore

Në Gjykatën Themelore, Departamenti i Krimeve të Rënda në Prishtinë, nëseancën gjyqësore të mbajtur për shkak të veprave penale; hyrja në sistemet kompjuterike, detyrimi dhe shantazhi, seanca gjyqësore e caktuar për datë 10 janar 2017, me numër të lëndës Pkr. 476/15, nuk është mbajtur pasi që ka munguar kryetarja e trupit gjyqësor, Valbona Selimaj,

25 BIRN ju ka dërguar pyetje Këshillit Gjyqësor të Kosovës përsëri në muajin maj 2018 dhe nga përgjigjet është kuptuar se përpos Gjykatës Themelore të Prishtinës, lëndë të parashkuara ka edhe në Gjykatën Themelore të Ferizajt ku janë gjithsej 3 lëndë të parashkuara të korrupsionit.

26 BIRN ka kërkuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës përsëri në muajin maj 2018 të dijë për profilin e rasteve të parashkuara por nuk ka pranuar asnjë përgjigje.

27 Interesimi i BIRN ka bërë që të sqarohet mospërputhja e të dhënave mes KGJK-së dhe gjykatave, pasi që është gjetur se Gjykata Themelore në Ferizaj nuk kishte ndonjë rast të parashkrimit por gabimisht ishte përcjellur në formularët e plotësuar.

e cila sipas gjyqtares Nora Blaca ka qenë në një udhëtim jashtë vendit dhe për shkak të motit të lig nuk ka mundur të prezantojë në gjykim.

Ky është një rast ku seanca fillestare është mbajtur në nëntor të vitit 2015, ndërsa shqyrtimi i dytë as në janar nuk është mbajtur.²⁸

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti i Krimeve të Rënda, në seancën gjyqësore të planifikuar për t'u mbajtur më datë 16 janar 2017 për shkak të veprave penale marrja dhe dhënia e ryshfetit, si dhe Ushtrimi i ndikimit, seanca gjyqësore nuk qe mbajtur.

Gjykimi ishte shtyrë në mungesë të prokurores së rastit, Ikramije Bojaxhiu, e cila ka marrë pozitë të përhershme si anëtare e komisionit për vlerësimin e performancës së prokurorëve në KPK. Përkundër se kjo ka ndodhur më shumë se tre javë më parë, asnjë prokuror nuk e ka zëvendësuar prokuroren në një seancë ku shumë herë ka pas shtyrje e gjithashtu njërit prej të akuzuarve veçse i është parashkruar lënda, Rajan Zenelit.²⁹

Në lëndën me numër PKR.376/16, të planifikuar të mbahet më datë 23 shkurt 2017, për shkak të veprës penale të Fajdes, seanca gjyqësore nuk qe mbajtur për arsye se mungoi prokurorja, Dulina Hamiti, e cila sipas kryetares së trupit gjykues ka qenë në një trajnim në Shqipëri, ndërsa Prokuroria Themelore e Prishtinës nuk ka dërguar asnjë prokuror për zëvendësim.

Është shumë brengosëse me sa lehtësi shtyhen seancat gjyqësore dhe sa pak përgjegjësi kanë palët në procedurën penale në Kosovë lidhur me shtyrjen e seancave gjyqësore.³⁰

Në Gjykatën Themelore të Gjakovës, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në rastin numër PKR.225/14, të planifikuar për t'u mbajtur më datë 15 mars 2017 për shkak të veprës penale të fajdes, seanca gjyqësore kishte dështuar për shkak të mos prezencës së prokurores së rastit.

Në këtë seancë gjyqësore, nuk ishte e pranishme prokurorja e shtetit e cila kishte prezentuar në këtë lëndë në dy seancat e mëhershme, Shpresa Bakija. Në mungesë të prokurores, e cila nuk kishte njoftuar paraprakisht për mos prezencën por që ishte në një shqyrtim tjetër në sallën numër 1, kjo seancë u shty për datën 29 mars 2017.³¹

Në Departamentin e Krimeve të Rëndatë Gjykatës Themelore të Prizrenit, në rastin me numër të lëndës P.nr.221/16, të datës 15 maj 2017, në rastin e keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, seanca gjyqësore dështoi për shkak të mungesës së prokurores së rastit.

Seanca gjyqësore nuk u mbajt për shkak të vonesës së prokurores e cila kishte njoftuar kryetarin e trupit gjykues me shkrim se nuk do të prezantojë në seancë për shkak se ka për të përfaqësuar në Gjykatën Themelore të Ferizajt në rastin e të akuzuarit Granit Paçarizi, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë.

Trupi gjykues mori vendim me të cilin caktoi seancën e radhës pas dy muajve, më datë 10 korrik 2017. Kjo shtyrje dhe zvarritje e seancës gjyqësore të korrupsionit për kohë kaq të gjatë bie ndesh me KPPK, në të cilin parashihet që gjykimi para trupit gjykues të perfundojë brenda afatit prej 120 ditësh.³²

Në Gjykatën Themelore të Gjakovës, Departamenti i Përgjithshëm, në lëndën me numër P.nr. 838/16, të planifikuar për t'u mbajtur më datë 5 qershor 2017, për shkak të veprës penale të Kanosjes ndaj prokurorit të shtetit, seanca gjyqësore nuk u mbajt ngase askush nga prokuroria e shtetit nuk prezantoi në gjykatë.

28 Gjyqtarja; Valbona Selimi, prokuror; Abdurrahim Islami, të akuzuarit; Armend Muja me avokat Ramë Gashi, Basri Muja, Ferdije Zhushi-Hetemi dhe Naim Braha. I dëmtuar; "Biomedica" dhe "ISPE".

29 Kryetar i trupit gjykues; Shadije Gerguri, anëtarët; Beqir Kalludra dhe Albina Rama, prokurore; Ikramije Bojaxhiu, të akuzuarit; Esat Belaj, Leonard Bytyqi, Albion Haxhijaha, Armona Orllati, Arian Janova, Gazmend Maliqaj, Mevludin Beqiri, Kemajl Gashi, Kushtrim Morina-av. Asdren Hoxha dhe Arton Hoti, Muhamed Maliqi dhe Shaqir Reciqja.

30 Kryetare e trupit gjykues; Valbona Musliu- Selimi, anëtarët; Nora Blaca-Dula dhe Vesel Ismajli, prokurori; Dulina Hamiti (mungoi), të akuzuar; Xhelal Hoxha me avokat Bahtir Troshupa, Flamur Hoxha, Nuhi Hoxha, Hamdi Jashari me avokat Asdren Hoxha.

31 Kryetar i trupit gjykues; Gëzim pozhegu, anëtarët; Diana Sina dhe Myfera Hoxha, prokuror; Shpresa Bakija (mungoi), I akuzuari; Naim Tariani me avokat Gani Gexha.

32 Kryetar i trupit gjykues; Xheladin Osmani, anëtarët; Ajser Skenderi dhe Altiya Fazli, prokurori; Ervehe Gashi, I akuzuari; Sherif Berisha me avokat Brahim Sopa.

Gjyqtarja e rastit, Ilirjana Hoti, bëri përpjekje të shumta duke thirrur përmes telefonit prokurorët e Prokurorisë Themelore të Gjakovës, mirëpo asnjëri prokuror nuk ishte i lirë. Ajo kontaktoi edhe me punëtorin e ndarjes së lëndëve në Prokurorinë Themelore të Gjakovës, nga i cili u njoftua se kjo lëndë nuk gjendet në regjistrat e Prokurorisë së Gjakovës.

Nga ana tjetër prokurori Besim Susuri, me lejen e gjykatës përmes telefonit e konfirmoi se Prokuroria e Prizrenit në muajin shkurt e kishte proceduar këtë lëndë në Gjakovë. Të pranishëm në gjykatë ishin i akuzuari Eshref Qafleshi dhe i dëmtuari, Prokurori Besim Susuri, mirëpo për shkak të mos prezencës së ndonjërit nga prokurorët e Prokurorisë së Gjakovës, seanca gjyqësore nuk u mbajt ndërsa seanca e radhës u caktua për datën 5 korrik 2017.³³

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti i Krimeve të Rënda, në rastin PKR.658/16, të datës 25 prill 2017, për shkak të veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, seanca gjyqësore nuk u mbajt.

Në seancë munguan të akuzuarit: Murat Meha, Ismet Kryeziu, Nemanja Spasiq ndërsa nuk kishte as prokurori i rastit.

Prokurore e këtij gjykimi ishte caktuar Fikrije Fejzullahu, por ajo ka kaluar me punë në Prokurorinë Speciale, ndërsa për caktimin e një prokurori të ri, gjyqtari Shashivar Hoti tha se e ka kontaktuar kryeprokurorin. Vetëm gjyqtari Shashivar Hoti ishte i pranishëm në këtë seancë.³⁴

Në Gjykatën Themelore të Gjakovës, Departamenti i Krimeve të Rënda, të mbajtur më datë 23 maj 2017, për shkak të veprës penale të grabitjes, seanca gjyqësore nuk u mbajt dhe u shty për shkak të mungesës së prokurorit, i cili në të njëjtën kohë ishte i angazhuar në një seancë tjetër gjyqësore.³⁵

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në lëndën me numër P-pkr.270/16, të planifikuar për t'u mbajtur më datë 21 shtator 2017, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPK-së dhe Frikësimi gjatë procedurës penale nga neni 395 i KPK-së, seanca gjyqësore dështoi të mbahej për arsye të thjeshta teknike, ngase nuk mund të hapej një CD e cila duhej të administrohej si provë.³⁶

Kjo arsye e shtyrjes së gjykimit vë në pah faktin e mospërkushtimit dhe papërgatitjes për gjykim, pasi që për diçka kaq elementare shtyhet një gjykim i korrupsionit të nivelit të lartë ku i akuzuar është një prokuror shteti.

2. Mos caktimi i seancës gjyqësore

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti i Krimeve të Rënda, në lëndën me numër P.kr. 33/11, e planifikuar të mbahej më 12 janar 2017, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, ku akuzohen dy të akuzuar për vrasje mizore, ndërsa ky është trupi i tretë gjykues i këtij rasti.

Në maj të vitit 2016, pas ankesës së avokatëve mbrojtës, ky rast ishte kthyer në rigjykim dhe që nga atëherë nuk është caktuar asnjë seancë lidhur me këtë rast edhe pse të akuzuarit janë në paraburgim nga një kohë shumë e gjatë.

Rasti fillimisht ishte vendosur në korrik të vitit 2015 dhe dy të akuzuarit ishin dënuar me nga 30 vite burgim.

Kryetari i trupit gjykues është arsyetuar me faktin se anëtare e trupit gjykues në këtë rast ishte Afërdita Bytyqi e cila u zgjodh kryetare e gjykatës në Prishtinë dhe nuk ka mundur ta zëvendësojë anëtarin e trupit gjykues.³⁷

³³ Gjyqtari individual; Ilirjana Hoti, prokurori; nuk prezantoi askush (ishte seanca filestare), I akuzuari; Eshref Qafleshi, i dëmtuar; Besim Susuri.

³⁴ Gjyqtari individual; Shashivar Hoti, prokurori; Fikrije Fejzullahu, të akuzuar; Murat Meha, Ismet Kryeziu, Nemanja Spasiq. I dëmtuar; ShPK "Marigona Residence".

³⁵ Gjyqtari individual; Shaqir Zika, prokurori; Agron Matjani, I akuzuar; Qerqiz Lilaj me avokat Avdi Rizvanolli, I dëmtuar; Shefik Arllati.

³⁶ Kryetari i trupit gjykues; Aziz Shaqiri, anëtarët; Venhar Salihu dhe Veli Kryeziu, prokurori; Arben Ismajli, të akuzuarit; Bajram Hamitaga dhe Luan Delili, i dëmtuar; Granit Pacarizi.

³⁷ Kryetari i trupit gjykues; Arben Hoti, anëtarët; Afërdita Bytyqi dhe Syzana Qerkini, prokuror; Fikrije Krasniqi, i akuzuari; Gezim Retkoceri me avokat Fehmije Gashi bytyqi dhe Osman Spahiu me avokat

Ky është një arsytim i papranusheshëm sepse një lëndë e fillë, kaq e rëndë dhe me një tension tepër të lartë në mes të dy familjeve do të ishte dashur të trajtohet me prioritet dhe jo nga maji 2016 deri në janar të mos caktohet asnjë seancë. Anëtarja e trupit gjykues e këtij rasti, Afërdita Bytyqi tek në dhjetor është zgjedhur kryetare e trupit gjykues.

Po ashtu në **Gjykatën Themelore të Prishtinës**, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në rastin penal me numër të lëndës PKR-372/16, të mbajtur më datë 13.07.2017, për shkak të veprës penale Organizim ose pjesëmarrje në grup teorririst nga neni 143 par.2 të KPRK-së,³⁹ në gjykimin e kthyer në rigjykim, mbi një vit nuk u caktua asnjë seancë gjyqësore.

Në këtë rast dy persona akuzohen për pjesëmarrje në grupe terroriste. Në aktakuzë, prokuroria pretendonte se dy të akuzuarit kanë qenë pjesë e organizatave terroriste. Prokuroria përmend si organizatë terroriste një organizatë me emrin "Harausham". KALLXO.com kishte raportuar se një organizatë e tillë nuk ekzistonte por përkundër kësaj Gjykata e Shkallës së Parë i kishte dënuar me nga 3 vjet e gjysmë burg por Gjykata e Apelit e kishte kthyer lëndën në rigjykim.

Të akuzuarit ishin dënuar në janar të vitit 2016 ndërsa në qershor 2016 lënda ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit dhe që nga ajo kohë nuk ishte caktuar asnjë seancë deri më 13 korrik 2017 në rigjykim. Pikërisht 1 vit pasi lënda u rikthye në rigjykim prokuroria ndryshoi aktakuzën duke thënë se emri "Harausham", ishte përkthyer gabimisht sepse bëhej fjalë për organizatën "Ahras al Sham", dhe kërkoi që tërë aktakuza të përmirësohet. Në këtë rast dy persona ishin dënuar për një organizatë që nuk ekzistonte në realitet fare përdërisa ka edhe shumë zvarritje të lëndës.

Në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në lëndën me numër PAKR-207/2017, të mbajtur më datë 14.07.2017 për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPRK-së,³⁹ seanca gjyqësore u caktua me tetë muaj vonesë.

Ky është një rast i cili në shkallë të parë është gjykuar në dhjetor të vitit të 2016 ndërsa seanca në Gjykatën e Apelit mbahet pas gati 8 muajsh e që flet për një zvarritje të madhe të këtij rasti të korrupsionit ku i dënuar nga Gjykata Themelore e Prishtinës është një ish-zyrtarë i lartë publik.

3. Ndërrimi i deklaratave të dëshmitarëve

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Departamenti i Krimeve të Rënda, në seancën gjyqësore të mbajtur më 7 shkurt 2017, për shkak të veprave penale të fajdeve, detyrimit, krimit të organizuar dhe organizimit të lojërave të bixhozit, në çështjen penale P.nr.85/16, dëshmitari ndërroi deklaratat e dhëna në procedurë paraprake.

Gjatë kësaj seance pati ndryshime të deklaratave të dëshmitarëve, sidomos dëshmitari Fadil Gashi, i cili në tërësi e ndërroi dëshminë e tij nga ajo e dhënë në polici e prokurori, ndërsa nuk pati asnjë reagim serioz nga ana e prokurorisë për inicim të veprës penale për deklaram të rremë!

Dëshmitari Fadil Gashi, pronar i kompanisë "Dili Commerc" kur u ballafaqua nga prokurorja me deklaratat e tij të dhëna në polici, ku kishte deklaruar se i kishte marrë 45 mijë euro nga Tunë Kqira që t'ia kthejë brenda dy jave 50,000.00 Euro, ai në gjykatë mohoi dëshminë e tij të dhënë në polici, duke deklaruar se nuk ka marë asnjëherë para me kamatë nga i akuzuari Tunë Kqira.

Dëshmitari Gashi tha se të hollat nga Kqira i kishte marrë për shkak të shitjes së banesës në vlerën prej 50,000.00 Euro, të holla të cilat i ishin dashur për shërimin e njërit nga familjarët e tij!

Dëshmia e tij ishte në kundërshtim të plotë me atë që kishte deklaruar gjatë fazës së hetimeve dhe ndaj tij nuk pati asnjë inicim të procedurës për deklaram të rremë.⁴⁰

Ramë Dreshaj. I dëmtuar; Familja e Naim Hajrizit, me përfaqësues avokatin Bajram Tmava.

38 Gjyqtari individual; Shadije Gerguri, prokurori; Elez Blakaj, të akuzuarit; Arben Livoreka dhe Nexhat Behluli

39 Trupi gjykues; Driton Muharremi kryetar, prokurori nga apeli nuk ka prezantuar në seancë dhe praktikisht nuk është ditë kush ishte prokuror, të akuzuarit: Hysni Hoxha-av. Tahir Rrecaj, idëmtuar; Kompanite "Caraglio SRL" dhe NTSh "Electra"

40 Kryetar i trupit gjykues; Xheladin Osmani, anëtarët; Artan Sejrani dhe Refki Piraj, prokurorja; Merita Bina- Rugova, të akuzuarit; Tunë, Marian, Gjon, Gjekson, Kastriot e Gëzim Kqira, si dhe Besfort Omaj,

Po ashtu në **Gjykatën Themelore të Prizrenit**, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në rastin me numër P.Nr.85/16, të mbajtur më datë 27 prill 2017, për shkak të veprave penale të krimit të organizuar, fajdeve e detyrimit, dëshmitari i propozuar për tu ndëgjuar ndërroi dëshminë e tij në gjykatë.

I vetmi dëshmitar që prezantoi në gjykatë ishte dëshmitari Avdi Zukaj. Ai para trupit gjykues deklaroi se e njeh vetëm të akuzuarin Gëzim Kqira, ndërsa tha se kishte pasur një herë një takim edhe me të akuzuarin Kastriot Kqira. Dëshmitari Zukaj, tha se të akuzuarit Gëzim Kqira i kishte shitur një pllac, i cili më pas nuk kishte dalur në rregull me dokumentacion dhe më pas Gëzimi i kishte kërkuar kthimin e të hollave nga ai.

Mirëpo, në këtë rast reagoi Prokurorja duke i cituar dëshminë e tij të dhënë në procedurë hetimore, e cila ndryshonte nga ajo që e kishte thënë më parë. Këtë pohim dëshmitari e arsyefoi para gjykatës, duke deklaruar se nga i akuzuari Gëzim Kqira kishte marrë 12 mijë euro dhe jo 10 mijë siç kishte deklarur më herët për t'i kthyer edhe dy mijë të tjera në formë të kamatës. Ai tha se 2 mijë euro i kishte marrë nga Gëzimi paraprakisht për nevoja të shkollimit të fëmijëve mirëpo nuk i kujtohej data kur i kishte marrë ato të holla dhe 10 mijë të tjera në këtë rast kur kishte lënë garancë pllacin e tij. Dëshmitari tha se paratë borxh ia kishte kërkuar vetëm Gëzimi dhe atë pa kurrfarë presioni, ndërsa tha se askush tjetër nuk e kishte thirrë për këtë punë.

Në ballafaqimin me dëshminë e tij, prokurorja i rikujtoi se kishte deklaruar se kishte pasur thirrje edhe nga Kastriot Kqira, gjë për të cilën dëshmitari në gjykatë tha se nuk i kujtohej.

Pas dëgjimit të këtij dëshmitari, Prokurorja Speciale kërkoi dëgjimin e zyrtarëve policorë të cilët i kanë intervistuar dëshmitarët për shkak se të njëjtit kanë ndryshuar deklaratat e tyre në gjykatë. Ajo tha se këtë propozim e bën me arsyetimin se dëshmitarët kanë ndryshuar dëshmitë e tyre nga frika e hakmarrjes nga të akuzuarit. Përderisa nuk ndërmori asnjë veprim procedural për ndërrimin e deklaratave të dëshmitarëve.⁴¹

4. Mos respektimi i afatit ligjor për mbajtjen e shqyrtimit fillestar

Në çështjen penale PKR. 369/16, të caktuar për t'u mbajtur më datë 28 shkurt 2017, në rastin Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor dhe dhënia e rryshfetit, përkundër se aktakuza në këtë rast është ngritur në qershor të vitit 2016, mbi 8 muaj, ende nuk është përfunduar seanca fillestare dhe ende nuk është lexuar aktakuza dhe nuk janë deklaruar të akuzuarit.

Kjo tregon për vëllimin e zvarritjes së kësaj lënde e cila krahas numrit voluminoz të akuzuarve, 64, ka pasur edhe probleme me dorëzimin e provave dhe shkresave të lëndës të të akuzuarit që nuk e kanë gjuhë amtare gjuhën shqipe por edhe të të akuzuarit tjerë.

Seanca këtë herë është shtyrë për shkak se ka munguar i akuzuari Bedri Sahiti ndërsa avokati i tij Gjuran Dema tha se i akuzuari i tij ka një problem shëndetësor.

Gjyqtarja nuk e pa të udhës që ta veçojë procedurën dhe të lexohet aktakuza ndërsa për të akuzuarin Bedri Sahiti të mbahet seanca e veçantë fillestare dhe jo 63 persona të jenë të pranishëm e të shtyhet seanca për vetëm një të akuzuar.

Mbajtja e shqyrtimit fillestar pas më shumë se 8 muajve, përkundër faktit që Kodi i Procedurës Penale të Kosovës përcakton se seanca fillestare mbahet 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës kur të akuzuarit janë në liri dhe 15 ditë kur ata ndodhen në paraburgim, është në kundërshtim me çdo dispozitë të paraparë ligjore.⁴²

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Departamenti i krimeve të Rënda, në lëndën me numër P.nr.22/17, të planifikuar të mbahet për datë 22 qershor 2017, në shqyrtimin gjyqësor, në rastin e 20 policëve të akuzuar për marrje të rryshfetit, për herë të tretë nuk arriti të përfundojë shqyrtimi fillestar.

Gjyqtari i rastit, Artan Sejrani, në fillim të shqyrtimit gjyqësor pyeti të pranishmit për plotësimin e kushteve për mbajtje të shqyrtimit gjyqësor. Prokurori Genc Nixha u deklarua

Ekrem Leci, Zyrafete Hukolli.

41 Kryetari i trupit gjykues; Xheladin Osmani, anëtarët; Artan Sejrani dhe Refki Piraj, prokurori; Merita Bina- Rugova, të akuzuarit; Tunë, Kastriot, Gjon, Marian, Gjekson e Gëzim Kqira, Benson Buza, Besfort Omaj etj.

42 Gjyqtari individual; Shadije Gerhuri, prokurori; Sylë Hoxha, të akuzuarit; Ferid Agani etj.

se janë plotësuar të gjitha kushtet, ndërsa nga mbrojtja nuk pati reagime. Pas marrjes së të dhënave nga 20 të akuzuarit, të gjithë zyrtarë policorë, prokurori lexoi aktakuzën voluminoze me të cilën i akuzon këta zyrtarë policorë se në bashkëkryerje kanë kryer nga dy, tri e deri në gjashtë vepra penale të marrjes së rryshfetit. Të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm, duke mos pranuar fajësinë.

Pas kësaj, në fund të shqyrtimit gjyqësor disa nga avokatët mbrojtës u deklaruan se nuk i kanë pranuar të gjitha shkresat e lëndës dhe si rezultat i kësaj pa sigurimin e provave për të pandehurit dhe mbrojtjen, avokatët kërkuar shtyrjen e shqyrtimit fillestar gjë e cila edhe ndodhi, duke bërë kështu të kalojnë muaj pa u arritur të mbahet shqyrtimi fillestar në këtë rast të korrupsionit.⁴³

Po ashtu, në **Gjykatën Themelore në Prishtinë** në Departamentin e Krimeve të Rënda, në rastin me numër PKR.656/16, të datës 7 mars 2017, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, seanca e shqyrtimit fillestar nuk u mbajt në afatin e paraparë ligjor.

Aktakuza në këtë rast është ngritur më datë 6 nëntor 2016, ndërsa seanca fillestare është mbajtur më 7 mars 2017, pra pas katër muajve apo 121 ditëve qëkur është ngritur aktakuza.

Gjithashtu, në këtë rast Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës nuk ka lëshuar komunikatë për dallim prej rasteve tjera të profilin të lartë siç është, në këtë rast, gjykimi i të akuzuarit Ramë Buja –ish-ministër i arsimit.⁴⁴

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti i Krimeve të Rënda, në lëndën me numër P.KR.5/17, të mbajtur më datë 28 prill 2017, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, seanca fillestare u mbajt më 28 Prill 2017, ndërsa aktakuza është ngritur më 6 shkurt, gati tre muaj pas ngritjes së aktakuzës, çka do të thotë se është mbajtur jashtë afatit ligjor që përcaktohet me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.⁴⁵

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në rastin me numër të lëndës P.kr. 118/16, të caktuar për t'u mbajtur më datë 17 maj 2017, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, seanca gjyqësore nuk është mbajtur për arsye se mbrojtja nuk janë pajisur me shkresat e lëndës ashtu siç kërkohet me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe seanca është shtyrë për një datë tjetër.

Kjo është hera e dytë me radhë që po shtyhet seanca e këtij rasti.

Gjithashtu përkundër asaj se aktakuza është ngritur në muajin nëntor 2016, edhe në maj të vitit 2017, pas gjashtë muajve, ende nuk është mbajtur seanca fillestare dhe përsëri nuk janë respektuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.⁴⁶

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në lëndën me numër Pkr. 685/16, të planifikuar për t'u mbajtur më datë 25 shtator 2017, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 i KPK-së,⁴⁷ edhe pse rast i korrupsionit rasti nuk është marrë me prioritet. Përkundër se aktakuza në këtë rast është ngritur para një viti dhe nuk është caktuar shqyrtimi fillestar, seanca

43 Gjyqtari individual; Artan Sejrani, prokurori; Genc Nixha, të akuzuarit; Shemsi Demolli, Safet Veliu, Naser Rama, Afrim Rafuna, Muhamet Buzhala, Ivica Djokic, Ismail Azemi, Alush Elshani, Blerim Zylfaj, Bekim Zogaj, Qerim Beqiri, Azem Goxhufi, Ardian Rrecaj, Sasha Nedeljko, Shaban Gerguri, Shemsi Zejnullahu, Aziz Krasniqi, Lulzim Gashi, Shefki Zeka dhe Nuhi Zogaj.

44 Gjyqtari individual; Valon Kurtaj, prokurori; Ali Rexha, të akuzuar; Ramë Buja me avokat Petrit Dushi, Xhemajl Buzuku me avokat Florent Latifaj, Xhavit Dakaj –s'ka avokat, Afrim Demiri me avokat Ramë Dreshaj. Aktakuza ndaj Ramë Bujës dhe të akuzuarit Xhavit Dakaj është hedhur poshtë.

45 Gjyqtari individual; Beqir Kalludra, prokurori; Agron Bajrami, të akuzuar; Shukri Buja me avokat Arianit Koci, Nebih Zeqiri, Halit Gashi, Fahri Retkoceri, Hasim Vishesella, Edmond Rexhepi, Driton Avdiu, Burim Kodra, Bajram Rizani dhe Magbule Sadiku.E dëmtuar; Komuna e Lipjanit.

46 Gjyqtari individual; Shashivar Hoti, prokurori; Kushtrim Munishi, të akuzuar; Murat Meha me avokat Ibrahim Dobruna, Ismet Kryeziu dhe Nemanja Spasiq. Aktakuza në këtë rast është hedhur nga Gjykata Themelore dhe është vërtetuar nga Apeli.

47 Gjyqtari individual; Shashivar Hoti, prokurori; Romulu Mateus, të akuzuarit; Sami Lushtaku, Emrush Thaqi, Shemsi Hajrizi, Sami Gjoka, Nexhip Shatri, Ismajl Dibrani, Agim Ukaj, Rrustem Rrukolli, Rexhep Xhota, Fatmir Mjaku, Bashkim Dervisholli, Valon Behramaj, Argjent Behrama, Mërgim Lushtaku, Dardan Geci dhe Mervete Hasani Lushtaku

fillestare nuk është mbajtur edhe në datën 25 tetor, për shkak se nuk janë plotësuar kushtet ligjore pasi që kanë munguar katër të akuzuar të cilët sipas gjyqtarit nuk i kanë pranuar ftesat!

Në Departamentin e Krimeve të Rënda, në Gjykatën Themelore të Prishtinës në lëndën me numër PKR-746/16 të mbajtur më datë 12 shtator 2017 për shkak të veprës penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 i KPK-së, pas më shumë se një viti qëkur është ngritur aktakuza dhe tri seancave të shtyra gjyqësore, më në fund më datë 12 shtator është mbajtur shqyrtimi fillestar në këtë rast të terrorizmit.⁴⁸

I akuzuari është sjellë me detyrim nga Policia e Kosovës ndërsa është deklaruar i pafajshëm përkundër se në deklarin e tij në hetuesi e kishte pranuar fajësinë. Ky rast tregon për zvarritjet gjyqësore dhe mosmbajtjen e seancave gjyqësore edhe kur janë në pyetje veprat e rënda penale.

5. Vonimi i drejtësisë

Në Gjykimin me numër të lëndës C.nr.1441/07, dështoi të mbahej seanca e planifikuar të mbahej më 22 mars 2017, për shkak të çështjes juridiko- civile të vërtetimit të pronësisë.

Ky rast ka fillimin që në vitin 2007 ndërsa ende nuk ka marrë një epilog në shkallën e parë të drejtësisë. Seanca e fundit është shtyrë pasi që gjyqtarja i ka njoftuar palët se nuk mund të jetë në seancë. BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA i është drejtuar me pyetje gjykatës por ende nuk ka pranuar përgjigje se cila ka qenë arsyeja e shtyrjes së një seance e cila zgjat që një kohë kaq të gjatë.

Sigurisht se rastet e tilla janë shembull shumë i keq i vendosjes së drejtësisë dhe dekurajojnë qytetarët që t'i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e problemeve të tyre.⁴⁹

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në lëndën me numër PKR-194/15, të caktuar për t'u mbajtur më datë 25.10.2017, për shkak të veprës penale, pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.2 të KPK-së, i njohur si rasti "Apex", për të cilin rast, prokurori Allen Cansick ishte vonuar me afatin e paraqitjes së aktakuzës, të cilën më pas gjyqtarja paraprake Catrien Witteman e kishte hedhur poshtë. Pas hedhjes së aktakuzës, prokuroria është ankuar në Gjykatën e Apelit dhe rasti ishte kthyer në rivendosje. Tani, ky rast gjykohet nga një gjykatës vendor, ndërsa edhe pse kanë kaluar gati 3 vjet nga ngritja e aktakuzës, ende nuk është kaluar në shqyrtim kryesor, duke bërë kështu që rasti si i filltë të stërzgjatet ende pa filluar gjykimin.⁵⁰

Në Departamentin e Krimeve të Rënda, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në lëndën me numër PKR.685/16, të caktuar për t'u mbajtur më datë 07.11.2017, për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422, edhe pse kishte kaluar më shumë se një vit qëkur është ngritur aktakuza ende nuk është mbajtur asnjë seancë e plotë lidhur me këtë rast, nuk është lexuar aktakuza dhe nuk janë deklaruar të akuzuarit. Madje prokurori Matues e ka quajtur turp për drejtësinë zvarritjen e lëndës, përdërisa në anën tjetër gjyqtari është arsyetuar me numrin e madh të lëndëve.⁵¹

6. Prishja e rendit në shqyrtim gjyqësor

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në lëndën

48 Gjyqtari individual; Vesel Ismaili, prokuror; Elez Blakaj, I akuzuar; Nexhat Ademi. Nexhat Ademi është dënuar me 3 vjet burg nga Gjykata Themelore ndërsa lënda është në Gjykatën e Apelit.

49 Gjyqtari; Hydajet Gashi, paditës; Muhamet dhe Pranvera Shala me përfaqësues avokatit Kushtrim Palushi, pala e paditur; Universiteti i Prishtinës.

50 Gjyaktësi individual; Vehbi Kashtanjeva, prokurori Allen Cansick, të akuzuarit; Arben Krasniqi – av. Donat Ebert and Granit Vokshi, Astrit Krasniqi – av. Destan Rukiqi , Arben Neziri – av. Ymer Osaj, Avni Morina – av. Kaqusha Avdiu zëvendësim, Gani Zeqiraj – av. Rrahman Kastrati me autorizim zëvendësues – Sadri Godanci , Muje Berisha – av. Zana Kusari, Kushtrim Hakaj – av. Xhafer Maliqi, Arsim Molliqaj –av. Qerim Metaj, Luan Halilaj – av. Haxhi Qekaj, Agron Hoxha – av. Merita Stublla EMini, Ilir Morina – av. Sevdali Zejnullahu. I dëmtuar; Kompaniae basteve APEX. Në muajin mars 2018 Gjykata e Apelit e ka hedhur poshtë aktakuzën në rastin Apex si të pasafatshme.

51 Gjykatësi individual; Shashivar Hoti, prokurori; Romulo Mateus, të akuzuarit; Sami Lushtaku, Emrush Thaqi, Shemsi Hajrizi, Sami Gjoka, Nexhip Shatri, Ismajl Dibrani, Agjent Ukaj , Rrustem Rrukolli, Rexhep Xhota, Fatmir Mjaku, Bashkim Dervisholli, Valon Behramaj, Argjent Behrama, Mërgim Lushtaku, Dardan Geci dhe Mervete Hasani Lushtaku.

me numër P.nr.193/16, të mbajtur më datë 11 korrik 2017, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, derisa prokurorja e rastit merrte në pyetje ekspertin financiar, pati shpesh ndërhyrje nga avokatët mbrojtës Hazër Susuri e Osman Hoxha. Kjo e bëri trupin gjykues që pas disa vërejtjeve verbale, të bëjë pauzë prej 15 minutave për shkak të reagimeve të mbrojtjes.

Kryetari i trupit gjykues, Xheladin Osmani, konstatoi në procesverbal se pauza bëhet për shkak të avokatit Osman Hoxha, për të cilin tha se e pengoi rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor duke e paralajmëruar se nëse vazhdon me ndërhyrje të tilla, do t'i shqiptohet gjoba, ndërsa nuk shfrytëzoi të drejtën për t'i shqiptuar gjobë ashtu siç parashihet në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, konkretisht neni 302 par.1 të KPPK-së.⁵²

Po ashtu, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në **Gjykatën Themelore të Prizrenit**, në rastin P.nr. 10/2016, të mbajtur më datë 5 prill 2017, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë dhe lëndim i lehtë trupor, seanca gjyqësore u ndërpre për shkak se avokati Esat Gutaj paralajmëroi që fjalën përfundimtare do ta bëjë me shkrim brenda tri ditësh, ngase u ndje i penguar nga kryetari i trupit gjykues.

Derisa avokati Esat Gutaj jepte fjalën përfundimtare pati disa herë ndërhyrje/ ndërprerje nga ana e kryetarit të trupit gjykues. Në pjesën e fundit të fjalës së tij, ai përmendi rastet që kanë ndodhur në qendrat e paraburgimit në Kosovë të cilën gjë nuk e lejoi kryetari i trupit gjykues të vazhdonte dhe avokati pas disa herë paralajmërimeve që do t'ia ndërpresë fjalën, ai vendosi që fjalën e tij përfundimtare ta ndërpresë për shkak, siç i quajti ai, ndërprerjet dhe pengesat e pa nevojshme të kryetarit të trupit gjykues dhe paralajmëroi se fjalën përfundimtare do ta sjellë me shkrim në gjykatë.⁵³

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në seancën gjyqësore të mbajtur më datë 18.07.2017 me numër të lëndës PKR.162/17, për shkak të veprës penale, përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës nga neni 144 par.4 dhe vepra penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së,⁵⁴ gjatë elaborimit të fjalës përfundimtare të avokatit Asdren Hoxha, një asistente/procesmbajtëse apo praktikante e gjykatës qëndronte pranë gjyqtarës Valbona Selimaj dhe i fliste diçka në vesh ndërsa gjyqtarja vetëm e dëgjonte pa biseduar. Kjo bëri që avokati Hoxha, të reagojë duke kërkuar vëmendjen e kryetares së trupit gjykues ndërsa në këtë rast kanë ndërhyrë anëtarët Valon Kurtaj dhe Vesel Ismajli duke i thënë që të vazhdojë fjalën sepse ata janë kolegë dhe veprojnë ashtu.

Trupi gjykues duhet ta ketë parasysh se duhet të dëgjojnë me vëmendje gjithë procesin gjyqësor, e në veçanti fjalën përfundimtare të avokatëve apo elaborimin që ata bëjnë e jo të krijojnë përshtypjen e pa interesimit tek avokati dhe i mbrojturi i tij e gjithashtu edhe tek publiku.

7.Mbajtja e gjykimit pa prezencën e të akuzuarit

Në Departamentin e Krimeve të Rënda, të **Gjykatës Themelore të Prishtinës**, në rastin me numër të lëndës PKR.369/2016, të mbajtur më datë 19 maj 2017 për shkak të veprës penale, Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor, Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike dhe dhënie e rryshfetiit, kjo seancë gjyqësore u mbajt pa prezencën e dy të akuzuarve.

Përderisa në seancë kanë munguar dy prej të akuzuarve Murat Abazi dhe Halit Çitaku (Murat Abazi ka ardhur në gjysmë të seancës), është vazhduar me leximin e aktakuzës përkundër se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës që obligon që të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre të jenë në seancë.

52 Kryetari i trupit gjykues; Xheladin Osmani, anëtarët; Artan Sejrani dhe Alija Fazli, prokurori; Ervehe Gashi, të akuzuarit; Sali Ademaj me avokat Hazër Susuri dhe Hamdi Zymeraj me avokat Osman Hoxha. Prokuroria, në qershor të vitit 2018, është tërhequr nga ndjekja penale.

53 Kryetari i trupit gjykues; Xhevdet Elshani, anëtarët Luan Berisha dhe Fatmir Kastrati, prokurori; Mehdi Sefa, i akuzuari; Nebih Berisha, me avokat Esat Gutaj, e dëmtuar; Eliona Berisha.

54 Trupi gjykues; Valbona Selimaj, anëtarët; Valon Kurtaj dhe Vesel Ismajli, prokurori; Drita Hajdari, të akuzuarit; Besnik Latif-av.Albana Kelmendi, Gazmend Haliti-av.Asdren Hoxha, Enis Latifii-av.Sabrije Jashari, Milazim Haxhijav-av.Bajram Tmava dhe Fehmi Musa-av. Blerim Qela.

Gjyqtarja Shadije Gërguri pa veçuar fare procedurën për dy personat që kanë munguar, ka vazhduar me leximin e aktakuzës dhe deklarimin e të pandehurve.

Ky veprim konsiderohet shkelje e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, më saktësisht neni 384 pika 1.3 përcakton se mungesa e atyre prezencave të cilëve është e obliguar me ligj në seancë përbën shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës.⁵⁵

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në çështjen penale me numër të lëndës PKR 305/16, për shkak të veprave penale të pjesëmarrjes ose organizimit të grupit kriminal të organizuar dhe vepra tjera penale, të mbajtur më 11 janar 2017, edhe pse në mungesë të akuzuarve seanca gjyqësore vazhdoi pa ndërprerje.

Seanca gjyqësore e këtij rasti është kthyer nga fillimi. Ndonëse muaj më parë ishte mbajtur seanca fillestare dhe disa prej mbrojtësve të akuzuarve kishin dorëzuar kundërshtimet e tyre ndaj aktakuzës, gjyqtari i EULEX-it Victor Partal, është larguar nga Kosova dhe kjo lëndë i është ndarë në punë gjyqtari Vladimir Micula. Kjo ishte seanca e dytë fillestare, pra edhe pse aktakuza është ngritur në muajin maj të vitit të kaluar, rasti ende është në fazën fillestare.

Prokurori Censick, sipas kërkesës së gjyqtarit ka paraqitur aktakuzën e ndryshuar.

Në këtë seancë përsëri mungoi Liridona Beqiri dhe dy avokatë të dy të akuzuarve, Hasan Shaqiri dhe Haxhi Islami dhe në këtë rast sipas ligjit mbrojtja është e nevojshme.

Përkundër mungesës së të akuzuarve, gjyqtari Micula e shtyu seancën për këta tre persona, dhe me pjesën tjetër vazhdoi me deklarimin e fajësisë, dhe këtë e bëri pa veçuar fare procedurën penale.

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të gjithë të akuzuarit duhet të jenë të pranishëm në seancë gjyqësore, përpos nëse është veçuar procedura, gjë e cila në rastin konkret nuk ndodhi.

8. Përgatitja e dobët e prokurorëve për gjykim

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në gjykimin e planifikuar të mbahet për datë 15 qershor 2017, në lëndën me numër Pkr. 385/17 për shkak të veprës penale të korrupsionit, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, seanca gjyqësore dështoi të mbahej.

Seanca gjyqësore nuk u mbajt për arsye se ka munguar prokurorja Dulina Hamiti ndërsa zëvendësuesi i saj prokurori, Kujtim Munishi, u deklarua se nuk e ka fjalën përfundimtare të përgatitjes dhe ka kërkuar shtyrjen e seancës, gjë që edhe ka ndodhur dhe kështu seanca është shtyrë për një datë tjetër.

Kjo sjellje tregon efikasitetin e Prokurorisë në luftimin e rasteve të korrupsionit ku një rast i keqpërdorimit të detyrës zyrtare mbetet i papërfunduar denjësisht nga organi i akuzës për shkak të mos-përgatitjes së prokurorit në këtë rast.⁵⁶

Gjithashtu shtyrja e seancës shkakton humbje të kohës për Gjykatën, për palët në procedurë por edhe për vetë prokurorinë.

Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në Departamentin e Krimeve të Rënda, në seancën gjyqësore me numër të lëndës PKR.nr.476/15, të mbajtur më datë 06.06.2017, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, fillimisht seanca gjyqësore filloi me vonesë për të vazhduar më pas me pasivitet të prokurorit dhe njërit nga anëtarët e trupit gjykues.⁵⁷

Gjatë seancës gjyqësore, gjatë gjithë kohës anëtari i trupit gjykues, gjyqtari Vesel Ismajli nuk ka qenë aspak aktiv, gjatë gjithë kohës ka qenë i përgjumur, njëjtë është ndjerë

55 Gjyqtari individual; Shadije Gërguri, prokuror; Florije Salihu- Shamolli, të akuzuar; Ferid Agani, Gani Shabani etj.

56 Kryetari i trupit gjykues; Beqir Kalludra, anëtarët; Shasivar Hoti dhe Shadije Gërguri, prokurori; Kujtim Munishi, i akuzuar; Fevzi Hajdari me avokat Ramë Gashi dhe Taulant Tahirsylaj me avokat Behar Ejupi. I dëmtuar; Ramush Misini.

57 Kryetare e trupit gjykues; Valbona Musliu Selimaj, anëtarët; Vesel Ismajli, Nora Blaca, prokurori; Abdurrahim Islami, të akuzuarit; Basri Muja me avokat Bajram Tmava, Ferdije Zhushi Av.Gezim Kollçaku, Armend Muja Av.Rame Gashi. Të dëmtuarit; Kolegji "Universum", Kolegji "ISPE"

edhe Prokurori Abdurrahim Islami të cilit kohë pas kohe i mbylleshin sytë dhe nuk kishte aspak koncentrim!

9. Mos dërgimi i shkresave të lëndës

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit, në departamentin e Krimeve të Rënda, në lëndën me numër Pkr.275/15 të planifikuar për t'u mbajtur më datë 11 tetor 2017, për shkak të veprave penale të krimit të organizuar, fajde, detyrim dhe Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, seanca gjyqësore nuk u mbajt. Gjykimi dështoi për shkak se mungoi e akuzuara Zyrafete Hukolli, ndaj të cilës ishte hapur rast tjetër për kryerje të veprës penale të zjarrvënies së qëllimshme dhe u njoftua se e njëjta ndodhet në qendrën e ndalimit në Pejë.⁵⁸

Ajo që ishte e rëndësishme në këtë seancë gjyqësore, ishte fakti se avokati Arianit Koci u ankua në trupin gjykues se nuk kishte pranuar asnjë shkresë me të cilën do t'i bëhej me dije se Benson Buzës i është ndërprerë masa e arrestit shtëpiak. Avokati tha se asnjëherë nuk është duke pranuar shkresa nga gjykata që nga fillimi i këtij gjykimi.

Me këtë rast, reagime pati edhe nga prokurorja speciale Merita Bina- Rugova, e cila shprehu shqetësimin se po merren vendime nga trupi gjykues dhe nuk po njoftohet prokuroria e shtetit, me çka ka bërë që të humben edhe afatet për ankimim. Për këtë shqetësim të palëve në procedurë, kryetari i trupit gjykues njoftoi se është problem administrativ dhe jo i trupit gjykues, ngase trupi gjykues tha se ka proceduar me vendimet.

Mos pajisja me shkresat e lëndës, është shkelje procedurale dhe në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale, ngase palët duhet të njoftohen me shkresat e lëndës dhe të ushtrojnë të drejtën e ankesës ndaj vendimeve gjyqësore. Lidhur me këtë Kodi i Procedurës Penale decidivisht në nenin 474 par.3 thotë:

“Kopjet e vendimeve kundër të cilave lejohet ankesë dërgohen së bashku me udhëzime për të drejtën në ankesë”.

10. Mungesa e interpretëve gjyqësorë

Në Departamentin e Krimeve të Rënda, pranë Gjykatës Themelore të Prizrenit, në lëndën me numër P.nr.131/16, të mbajtur më datë 16.11.2017, për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, pos faktit që seanca gjyqësore filloi me 50 minuta vonesë, për shkak se prokurori në të njëjtën kohë ishte i angazhuar në një gjykim tjetër. Problem tjetër në këtë seancë gjyqësore ishte mungesa e interpretit gjyqësor për gjuhë boshnjake, gjë e cila bëri që seanca gjyqësore të ndërpritet për të vazhduar për një ditë tjetër.

Fjalën e tij përfundimtare me shkrim pos të akuauzrve tjerë, e kishte përgatitur edhe i akuzuari Bean Haxhahasani, drejtor i urbanizmit. Mirëpo, ai nuk mundi që ta elaboroj verbalisht fjalën e tij ngase mungoi përkthyesi adekuat i gjuhës boshnjake. Përkthyesi gjyqësor i pranishëm në gjykatore ishte i autorizuar të përkthente në gjuhën turke dhe ai u deklarua se nuk ishte në gjendje që ta përkthente fjalën përfundimtare të shkruar nga i akuzuari. Meqë përkthyes tjerë nuk pati në gjykatë, seanca gjyqësore u ndërpre, për të vazhduar për një datë tjetër.⁵⁹

V. Shkeljet teknike

Që nga fillimi i projektit të monitorimit të gjykatave, qysh nga viti 2008, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, vëmendje të veçantë i kanë kushtuar edhe trajtimit të problemeve teknike të cilat është dëshmuar se kanë qenë faktorë të cilët i kanë hapur rrugë problemeve

58 Trupi gjykues: Xheladin Osmani, anëtarët: Artan Sejrani dhe Refki Piraj, prokuror: Merita Bina-Rugova, të akuzuarit: Tunë, Marian, Gjon, Kastriot, Gjekson e Gëzim Kqira, Benson Buza, Besfort Omaj, Zyrafete Hukolli etj. Avokatët: Azem Vllasi, Ndrec Doda, Esat Gutaj, Hazër Susuri, Kosovare Kelmendi, Bahrie Besimi etj. Të dëmtuarit: Zef dhe Pal Gruda.

59 Kryetarja e trupit gjykues: Ajsër Skenderi, anëtarët e trupit gjykues: Teuta Krusha dhe Kimete Kicaj, prokurori: Genc Nixha, të akuzuarit: Salim Jenuzi (av. Ruzhdi Berisha), të tjerët pa avokat Bean Haxhahasani, Vetim Hasani dhe Nexhat Selaj.

tjera drejt shkeljeve procedurale.

Monitoruesit e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, edhe në vitin 2017 kanë hasur në raste kur seancat gjyqësore nuk fillojnë me kohë, nuk respektohet kodi i veshjes, përdoren telefonat gjatë seancave gjyqësore që ndikon drejtpërdrejt në humbjen e koncentrimin, gjykimet mbahen në zyrë të gjykatësit në vend se të mbahen në sallë të gjykimin, e po ashtu rastet kur gjykimet mbahen në sallë e nuk përdoret audio dhe video- incizimi zyrtar, deri te pasivitetit i gjykatësve kur ata janë të angazhuar si anëtarë në trupit gjykues.

Edhe pse çështja e shkeljeve teknike duket të konsiderohet si diçka e tejkaluar, në realitet të dhënat statistikore flasin ende për numër të këtyre shkeljeve.

BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA gjatë vitit 2017 kanë monitoruar 307 seanca gjyqësore, prej të cilave 284 janë monitoruar në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe 23 seanca gjyqësore janë monitoruar në Departamentin e Përgjithshëm.

DEPARTAMENTET

KRIME TË RËNDA

284 | 93%

TË PËRGJITHSHËM

23 | 7%

TOTAL

307

Tabela 7. Lëndët e monitoruara nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA

Nga 307 seancat gjyqësore të monitoruara, 89 prej atyre apo 29% e seancave të caktuara për gjykim nuk janë mbajtur, ndërsa 218 prej seancave gjyqësore janë mbajtur.

Numri prej 218 seancave gjyqësore të mbajtura, do të jetë mostër për matjen e të gjeturave nga shkeljet teknike në vazhdim.

A ËSHTË MBAJTUR SEANCA?

JO

89 | 29%

PO

218 | 71%

TOTAL

307

Tabela 8. Numri i seancave të monitoruara të cilat janë mbajtur dhe ato të cilat nuk janë mbajtur

Gjatë vitit 2017, seancat gjyqësore kanë vazhduar të lajmërohen si në monitorët e vendosur në hyrje të gjykatës, ashtu edhe përmes internetit, në ueb faqen e KGJK- së.

Nga 218 seancat e monitoruara, 168 kanë qenë të lajmëruara, përdërisa 50 prej tyre nuk kanë qenë të lajmëruara fare. Numri i seancave gjyqësore të palajmëruara edhe këtë vit del të jetë i lartë, në 23 për qind të seancave të monitoruara seancat nuk kanë qenë të lajmëruara edhe përkundër faktit se gjykatat tani kanë të angazhuar zyrtarët për informim.

Trajektorja e matjeve të BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA prej vitit 2010 e deri në vitin 2017 e lajmërimit të seancave gjyqësore në tabelën e shpalljeve duket si më poshtë:

A KA QENË E LAJMËRUAR SEANCA GJYQËSORE?

JO

50 | 23%

PO

168 | 77%

TOTAL

218

Tabela 9. Numri i seancave të lajmëruara përmes shpalljeve

Tabela në vijim, pasqyron seancat gjyqësore që kanë filluar me kohë dhe ato që kanë filluar me vonesë gjatë vitit 2017.

Sipas të dhënave statistikore, gjatë vitit 2017, 41% e seancave gjyqësore nuk kanë filluar me kohë.

A KA FILLUAR SEANCA GJYQËSORE ME KOHË?



Tabela 10. Numri i seancave të monitoruara që kanë filluar me kohë dhe ato që nuk kanë filluar me kohë

Ndër vite shumë seanca gjyqësore janë mbajtur nëpër zyre të gjyqtarëve në vend se të mbahen në sallat e gjykimit, andaj vendi i mbajtjes së seancave gjyqësore në vazhdimësi ka qenë objekt i interesit të monitorimit të BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA.

Sipas të dhënave që dalin nga monitorimi ynë, del se vetëm 9% e seancave gjyqësore të monitoruara janë mbajtur në zyre ndërsa pjesa tjetër e seancave të monitoruara që përbën 91%, janë mbajtur në sallë të gjykatës, me çka shënon edhe rritje të transparencës dhe gatishmërisë së gjykatave për të qenë të hapura për publikun.

KU ËSHTË MBAJTUR SEANCA?



Tabela 11. Vendi në të cilin është mbajtur seanca

Pas raportimeve të shpeshta nga monitoruesit e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA për mungesën e bartjes së uniformave nga gjyqtarët dhe palët në procedurë, Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial janë kujdesur që të sigurojnë uniforma për të gjithë gjykatësit dhe prokurorët. Të njëjtën gjë e ka bërë edhe Oda e Avokatëve të Kosovës.

Gjatë vitit 2017 vetëm në 6 për qind të seancave të monitoruara nuk është përdorur uniforma.

Trajektorja e matjeve të Raportit prej vitit 2010 e deri në vitin 2017 e mospërdorimit të uniformave duket si më poshtë:

A ËSHTË PËRDORUR UNIFORMA?



Tabela 12. Mospërdorimi i uniformave zyrtare në seanca gjyqësore

Nga 6 për qind e seancave të monitoruara, apo nga 12 seancat gjyqësore, numrin më të madh të mos përdorimit të uniformave e përbëjnë avokatët në 5 raste të monitoruara, të pasuar nga prokurorët dhe gjykatësit.

NGA KUSH ËSHTË PËRDORUR UNIFORMA?




Tabela 13. Palët në procedurë që nuk e kanë përdorur uniformën

Duke qenë se gjatë seancave gjyqësore prezentë janë palë të ndryshme, duke nisur nga avokatët, prokurorët, policia dhe publiku, e pos tyre edhe nga vetë gjyaktësit dhe trupi gjyqësor, edhe këtë vit Raporti ka bërë monitorimin e përdorimit të telefonave. Nga seancat e monitoruara gjatë vitit 2017, në 11 për qind të tyre janë përdorur telefonat.

Trajektorja e matjeve të Raportit prej vitit 2010 e deri në vitin 2017 e përdorimit të telefonave duket si më poshtë:

A ËSHTË PËRDORUR TELEFONI?



Tabela 14. Përdorimi i telefonave gjatë seancave

Nga 11 përqindëshi i përdorimit të telefonave, apo nga 23 seancat gjyqësore të monitoruara gjatë vitit 2017 në të cilat është përdorur telefoni, përqindjen më të madhe të përdoruesve e bëjnë avokatët me 11 raste, të pasuar nga vetë gjyqtarët dhe më pas edhe nga prokurori. Pjesën tjetër e përbëjnë palët tjera prezente në gjykim duke përfshirë policinë dhe publikun.

NGA KUSH ËSHTË PËRDORUR TELEFONI?




Tabela 15. Palët që kanë përdorur telefonin gjatë seancës

Audio dhe video- incizimi i seancave gjyqësore vazhdon të jetë njëra nga gjetjet më brengosëse të shkeljeve teknike edhe në vitin 2017.

Në 90 për qind të seancave të monitoruara nuk janë përdorur pajisjet për regjistrim zyrtar të seancave gjyqësore.

Mos-shfrytëzimi i mundësisë për incizim të seancave gjyqësore, e cila përcaktohet edhe me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, shpie në mos-përfilljen e këtij kodi, edhe përkundër faktit se gjykatat kanë përgatitje të paktën në njërin nga sallat për ta bërë një gjë të tillë.

A ËSHTË PËRDORUR AUDIO DHE VIDEO INCIZIMI NË SEANCËN GJYQËSORE ?



Tabela 16. Përdorimi i audio dhe video incizimit të seancës

Raporti i BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, në vitin 2016 përmes monitoruesve me përvojë të gjatë në monitorimin e gjykatave, duke parë pasivitetin e gjyqtarëve kur ata janë anëtarë të trupit gjykues, për herë të parë pati bërë matjen e aktivitetit të tyre në rolin e anëtarit të trupit gjykues. Të njëjtën gjë e ka vazhduar edhe në vitin 2017.

Shpeshherë gjyqtarë me përvojë të gjatë dhe të përkushtuar në punë kur është në pyetje emri i tyre, në gjykimet kur ata veprojnë të vetëm janë shumë aktivë ndërsa kur të njëjtit angazhohen në trupe gjykuese duket si një fenomen i kthyer në shprehje që ata t'i kaplojnë pasiviteti.

Nga matjet e bëra nga monitoruesit e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, nga viti 2016 në vitin 2017 ka përmirësime të dukshme në këtë drejtim.

Nga 218 seancat gjyqësore të mbajtura në 21 për qind të seancave gjyqtarët del të kenë qenë mesatarisht aktivë, në 18 për qind të seancave kanë qenë shumë aktivë, në 16 për qind kanë qenë pak aktivë, përdërisa në 10 për qind kanë qenë aspak aktivë. Krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit gjyqtarët kanë qenë më aktivë, ngase vitin e kaluar në 22 për qind të rasteve gjyqtarët kanë qenë aspak aktivë.

SA KANË QENË AKTIVË ANËTARËT E TRUPI GJYKUES?




Tabela 17. Sa kanë qenë aktivë anëtarët e trupit gjykues?

REKOMANDIMET

Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prokurorisë së Shtetit dhe Akademisë së Drejtësisë

Të rishikohet procesi i vlerësimit të performancës së prokurorëve në atë mënyrë që vlerësimi kualitativ të jetë bazë e vlerësimit të prokurorëve;

Të ndërmerren masa disiplinore ndaj prokurorëve të papërgatitur në seancat gjyqësore;

Të krijohen programe trajnuese të veçanta dhe të detyrueshme për prokurorët që ndjekin rastet e korrupsionit;

Të krijohen trajnime me fokus të veçantë në përgatitjen e prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen e krimeve financiare;

Të krijohen programe trajnuese të veçanta për të përmirësuar performancën e prokurorëve në drejtim të argumentimit dhe provimit të lidhshmërisë mes pasurisë së krijuar dhe veprës penale;

Të rritet numri i rasteve që në pajtim me Kodin e Procedurës Penale mund të zgjidhen përmes ndërmjetësimit;

Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Akademisë së Drejtësisë

Urgjentisht të rritet numri i gjyqtarëve në Gjykatën Themelore të Prishtinës;

Transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve të mos jetë i kufizuar në 6 muaj fillimisht dhe të gjenden mënyra që të pamundësohet rikthimi i gjyqtarëve të transferuar në gjykatat bazë pa i përfunduar lëndët që u janë ndarë në punë;

Të rishikohet procesi i vlerësimit të performancës së gjyqtarëve;

Të shqiptohen masa disiplinore ndaj gjyqtarëve që për shkak të mos-menaxhimit të duhur, shkaktojnë shtyrjen e seancave;

Të ndërmerren masa disiplinore ndaj gjyqtarëve që nuk respektojnë afatet e parapara me Kodin e Procedurës Penale dhe kështu shkaktojnë zvarritjen e lëndëve pa arsye;

Të ashpërsohet politika ndëshkimore në rastet e korrupsionit;

Të krijohen programe të veçanta trajnuese për gjyqtarët në rastet e korrupsionit dhe krimin ekonomik;

Të krijohen programe të veçanta trajnuese dhe të obligueshme për gjyqtarët me qëllim që të pajisen me njohuritë bazë në fushën e prokurimit pasi që numri më i madh i rasteve të korrupsionit ndërlidhet me shpenzimin e parasë publike;

Secili gjyqtar që ka raste të korrupsionit të ketë bashkëpunëtorë profesionalë;

Secila seancë gjyqësore e rasteve të korrupsionit të audio dhe video incizohet me pajisjet dhe për nevojat e gjykatës;

Të shqyrtohen rastet e mbylljes apo kufizimit të xhirimit të seancave gjyqësore pa arsytet dhe të shqiptohen masa disiplinore për shkak të këtyre shkeljeve;

Të qartësohet dhe rritet transparenca dhe qasja e shoqërisë civile në gjykatat e Kosovës. Në veçanti pas ngritjes së aktakuzave, ato duhet të jenë publike dhe të qasshme nga momenti i ngritjes në gjykatë dhe gjykatat duhet të mbahen përgjegjëse për mundësimin e qasjes.

Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë

Sa më shpejt të fillojë plotësim/ndryshimi Ligjit për Gjykatat në Kosovë dhe të parashihet krijimi i Gjykatës Speciale e cita do të kishte kompetencë trajtimin e lëndëve të Prokurorisë Speciale të Kosovës, me fokus të veçantë në rastet e korrupsionit;

Të procedohen sa më shpejt nga Kuvendi i Kosovës, projektligjet për Këshillin Gjyqësor dhe atë Prokurorial të Kosovës;

Të procedohet sa më shpejt që të jetë e mundur Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;

Kuvendi i Kosovës ta rrisë buxhetin për Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës në përputhje me kërkesat e paraqitura dhe pritshmëritë nga sistemi i drejtësisë;





The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records of all transactions. It emphasizes that every entry, no matter how small, should be recorded to ensure the integrity of the financial statements. This includes not only sales and purchases but also expenses, income, and any other financial activity. The document also highlights the need for regular reconciliation of accounts to identify any discrepancies early on.

In the second part, the author provides a detailed breakdown of the accounting cycle. It starts with identifying the accounting period and ends with the preparation of financial statements. Each step is explained in detail, including the necessary journal entries and the use of T-accounts to organize the data. The document also includes a sample journal entry to illustrate the process.

The third part of the document focuses on the classification of accounts. It explains how to distinguish between assets, liabilities, and equity accounts, and how to further categorize them into current and non-current items. This section is crucial for understanding the balance sheet and the statement of financial position.

Finally, the document discusses the importance of internal controls. It outlines various procedures that can be implemented to prevent errors and fraud, such as the separation of duties, the use of checks, and the regular review of accounts. The author concludes by emphasizing that strong internal controls are essential for the success of any business.

The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records in a business setting. It highlights how proper record-keeping can help in identifying trends, making informed decisions, and ensuring compliance with various regulations. The text emphasizes that records should be organized, up-to-date, and easily accessible to all relevant personnel.

Next, the document addresses the challenges associated with data management in the digital age. With the increasing volume of data generated by various sources, businesses face significant difficulties in storing, processing, and analyzing this information. The text suggests implementing robust data management strategies, such as data backup, security measures, and regular audits, to mitigate these risks.

The third section focuses on the role of technology in enhancing business operations. It explores how automation and digital tools can streamline processes, reduce errors, and improve overall efficiency. The document encourages businesses to invest in modern technology and provide training to their employees to maximize the benefits of these tools.

Finally, the document concludes by emphasizing the importance of continuous learning and adaptation in a rapidly changing business environment. It suggests that businesses should regularly evaluate their performance, seek feedback, and be open to new ideas and innovations to stay competitive and successful.

The first part of the document discusses the importance of maintaining accurate records in a laboratory setting. It emphasizes the need for clear labeling and consistent data entry to ensure the reliability of experimental results. The text also touches upon the ethical considerations of data handling and the responsibilities of researchers in this regard.

In the second section, the author delves into the technical aspects of the equipment used in the study. A detailed description of the calibration process is provided, along with a comparison of different measurement methods. The author highlights the challenges associated with precision and the steps taken to minimize errors throughout the data collection phase.

The third section presents the results of the experiments. The data is organized into several tables, each accompanied by a brief analysis of the trends observed. The author discusses the implications of these findings in the context of the broader field of research, noting both the strengths and limitations of the current study.

Finally, the document concludes with a summary of the key findings and a list of references. The author expresses a commitment to further research in this area and provides contact information for those interested in collaborating or accessing the full report.